



Fundjava/Suplementi për argëtimin

- Jorgaqi: Një jetë mbi biçikletë
- Kamenica: Rikthimi te xhazi

► Faqe 13-19

KËRKESAT

► Faqe 8-9

VOTIMI

► Faqe 7

PADIA

► Faqe 20

Statusi, shoqëria civile debat me ambasadorin Sequi

PD zgjedh kryetare Lefterie Lleshin, ja anëtarët e KQZ-së

“Vjehrra më hodhi nga shkallët, dua divorc nga burri”

[SHQIPTARJA.com]

TELEVIZIONI MË I RI INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!
origjina e lajmit...

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi FUNDJAVA

VITI II - NR. 242 E premte, 12-10-2012

KRIMI MAKABER NE DURRES

18-vjeçarja Ajshe Vata, e masakruar në një arë 450m larg banesës në Xhafzotaj

I PRITET KOKA



Në foto: Ajshe Vata, 18-vjeçarja që u gjet dje me kokë të prerë në Xhafzotaj të Durrësit

- **POLICIA: VRASJA RRETH ORES 03:30, SHOCK&MISTER**
- **KUJA E TE ATIT, MUHAMETIT: ME KANE VRARE VAJZEN**

Lajmi

18 vjeçarja Ajshe Vata për pak ditë do të fillonte infermeri në Universitetin e Tiranës dhe kishte përfunduar Medresenë e Durrësit. Ajo u gjet dje e masakruar nga një banor i fshatit të vet në një arë, e veshur vetëm me rrodbishan. Kishte edhe gjashtë motra të tjera, por nëna i kishte vdekur para disa vitesh. Babai, dëshmitarët e policia mbeten të shokuar për arsyet e motivet se pse mund të ketë ndodhur një vrasje kaq makabër.

Koment



NGA PREÇ ZOGAJ

Me vetëflim për Ligjin dhe të drejtën

DURRES

NGA I DËRGUARI YNË NË XHAFZOTAJ

HABJON HASANI

Një krim i pashembullt dhe makabër është regjistruar dje në Xhafzotaj të Durrësit, Ajshe Vata, një 18 vjeçare është gjetur e dekapituar (me kokë të prerë) në një tokë të djerrë rreth 450 metër distancë nga vila ku ajo banonte me familjen e saj. Trupi është gjetur krejt rastësisht nga i zoti i tokës, rreth orës 08:30 të mëngjesit...

► vijon në faqe 2-3

TË DJEGURIT

► Faqe 4-5



PS: Ndreca dhe Bejko, kurim jashtë. I treti tenton të vetëdijet

Dhjetra programe bachelor dhe master në degë ekonomike dhe inxhinierike

cel: 0696070111
www.umt.edu.al

UMT
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

Parantezë

E marr me mend se duke parë flakët në trupin e Gjergj Ndreçës dhe Lirak Bejkos shumë njerëz në Shqipëri dhe në botë kujtojnë studentin njëzet e një vjeçar çek, Jan Palach, i cili i vuri flaken vetes në qendër të Pragës në vitin 1969 për të protestuar kundër represionit sovjetik. Unë po kujtoj ndërkaq edhe vetëdijegjen e tmerrshme në pyjet e Pukës të Lukë Ndue Lleshit në 11 korrik të vitit 1987. I internuar në Tepelenë qysh fëmijë bashkë me të vëllanë, Zefin, ngaqë rregjimi komunist u kishte vrarë babanë, i burgosur pastaj për tentativë arratisjeje, i munduar fizikisht e shpirtërisht deri në pikën ku qenia njerëzore e ka të vështirë të mbajë, Luka e la më në fund luftën që kishte bërë deri atëherë dhe vendosi të bënte një kryengritje tjetër, kryengritjen goditëse, finale: u fut thellë në pyll, përgatiti turmën e shkapave dhe degëve, endezi, pritë derisa flakët morën mirë dhe u hodh në to për tu djegur si... ► vijon në faqe 8



AKTUALITET

Tragjedia

VRASJA MAKABRE Ajshe Vata mbante të veshur një këmishë nate ngjyrë blu ndërsa skena e krimit përmbante dhe një element që shtonte makabritetin, vrasësi e ka zhvendosur kokën e viktimës



Tmerr në Durrës, gjendet 18-vjeçarja me kokë të prerë

Hetim në pistat e krimit brenda familjes dhe krim pasioni

■■■ DURRES

HABJON HASANI

vijon nga faqja 1



Ajshe Vata, 18-vjeçarja që u gjend me kokë të prerë

...të djeshëm, Ajshe Vata mbante të veshur një këmishë nate ngjyrë blu ndërsa skena e krimit përmbante dhe një element që shtonte makabritetin, vrasësi e ka zhvendosur kokën e viktimës dhe të paktën deri në mbërmbjen e djeshme policia tha se nuk kishte mundur ta gjente. Gjithçka është zbuluar fillimisht nga Sabri Balla, një 65 vjeçar i cili banon në "4 Rugët e Shijakut" por që ka në pronësi një tokë bujqësore në Xhafzotaj. Sabri Balla ka shkuar dje herët në mëngjes te toka e tij por ajo çka ka parë e ka tmerruar dhe pasi ka konstatuar trupin e shtrirë dhe pa kokë të një femre, ai ka vrapsuar për të kërkuar ndihmë. Sabri Balla nuk ka patur telefon dhe për këtë arsye është drejtuar tek një kabinë e hekurudhës që ndodhej aty pranë duke i kërkuar punonjësit të kabinës, shtetasit 51 vjeçar Besim Lame që të telefononte policinë. Ky i fundit ka bërë telefonatën dhe menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur disa efektive të policisë së Shijakut, të cilët kur kanë parë skenën kanë raportuar menjëherë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe te eprorët e tyre në Drejtorinë e Durrësit.

KËRKIMI

Pasi kanë rrethuar zonën hetuesit e policisë kanë nisur përpjekjet për identifikimin e viktimës. Rreth orës 09:20 kërkimet e policëve koinciduan me alarmin që kishte dhënë Muhamet Vata, babai i Ajshe Vatës i cili kishte konstatuar mungesën e të bijës në shtëpi. Pasi është shoqëruar në tokën e djerrë ku ishte gjetur trupi, i ati i Ajshe Vatës menjëherë ka kuptuar se personi i gjetur pajetë dhe me kokë të prerë ishte vajza e tij. Identifikimin e ka pajtur të lehtë ta bëjë kryesisht nga teshat të cilat mbante të veshura 18 vjeçarja. Muhamet Vata më pas ka vënë kujtën dhe është kthyer në oborrin e vilës së tij ku fqinjët dëshmojnë se u ka thënë: "Më kanë vrrarë vazon mor, m'a kanë masakru". Të gjithë familjarët e Ajshe Vatës kanë qëndruar për rreth 20 minuta në oborrin e shtëpisë, ndërsa me urdhër të


I ati

"Deri në orën 23:00 ka qenë në shtëpi dhe ka shkuar si çdo natë në dhomën e saj për të fjetur gjumë". - mësohet t'u ketë thënë hetuesve i ati.

djeshme në përpjekje për të kuptuar më shumë rreth Ajshe-s dhe krimit të saj.

PISTAT

"Është një krim shumë i sofistikuar, aktualisht kemi pak prova direkte, por ajo çka është e qartë është se personi që ka kryer krimin e ka menduar gjatë dhe e ka planifikuar me kujdes", - i tha dje Shqiptarja.com një oficer i policisë së Durrësit që ka marrë në pyetje dy prej familjarëve të viktimës 18 vjeçare Ajshe Vata. Mësohet se nga deponimet e bëra në polici, babai i Ajshe Vatës ka deklaruar se vajza e tij ka qenë në shtëpi të paktën deri në orën 23:00 të mbrëmjes të së mërkurës. "Deri në orën 23:00 ka qenë në shtëpi dhe ka shkuar si çdo natë në dhomën e saj për të fjetur gjumë", - mësohet tu ketë thënë hetuesve i ati. Ajshe Vata kishte dhomën e saj në katin e dytë të vilës.



Dedikimi për Ajshe-n, marrë në fotoprofilin në "Facebook" të shoqeve të saj

Sipas hetuesve zgjidhja e rebusit është e fshehur e gjitha në atë se çfarë ka ndodhur gjatë natës me Ajshe Vatën. "Nuk kemi të përcaktuar se në çfarë ore ka dalë nga shtëpia, në çfarë ore të natës apo të mëngjesit herët, por ende nuk dimë me saktësi se për çfarë ka shkuar në arën ku e kanë vrrarë Ajshe Vata. Nëse ka shkuar e vetme në takim, apo ka dalë nga shtëpia e shoqëruar",

- tha dje një ekspert i policisë. Aktualisht policia ka dy pista hetimi, e para lidhet me të dyshuar brenda rrethit familjar të Ajshe Vatës, ndërsa pista e dytë lidhet me ndonjë krim pasioni. Ajshe Vata që prej vitit 2006 ka mbetur jetime pasi nëna e saj vdiq pas lindjes së djalit të familjes. Ajo ka pesë motra dhe një vlla , ndërsa njëra nga motrat e ka motër nga babai.

Praktikante fetare

Poezitë e Ajshe-s për nënën e vdekur në 2006

■■■ TIRANE



Faksimile e faqes së Ajshe Vatës në "Facebook"

Pasi ka shoqëruar familjarët e Ajshe Vatës në policinë e Durrësit disa hetues kanë bërë "krehjen" e vilës dhe sidomos të dhomës në katin e dytë ku qëndronte Ajshe Vata. Hetuesit kanë gjetur në dhomën e saj telefonin personal, telefoni është gjetur i fikur. "Telefonin personal të viktimës Ajshe Vata e kemi sekuestruar dhe e kemi dërguar menjëherë në laboratorin kriminalistik për të bërë një kyryje të plotë dhe për të parë nëse nëpërmjet këtij telefoni do të mund të zbardhim element të rëndësishëm që lidhen me njerëzit që ajo komunikonte në vazhdimësi por edhe në lidhje me ndonjë detaj natën e ngjarjes", thanë dje burime policore. Mbrëmjen e djeshme rreth orës 19:40 mjekët ligorë kanë përfunduar edhe autopsinë e vik-

timës. Rezultatet e autopsisë kanë përcaktuar edhe intervalin kohor kur mund të jetë kryer dekapitimi i viktimës, ndërsa ky interval është përcaktuar paraprakisht të pa-

ktën pesë orë përpara gjetjes së trupit. Pra vrasja është kryer përpara orës 03:30 të mëngjesit të djeshëm. Një tjetër element i dalë nga autopsia është fakti se viktima

Ajshe Vata nuk ka kryer marrëdhënie seksuale në 24 orët e fundit të jetës së saj.


ADOLSEHENCA

Ajshe Vata, një 18 vjeçare që është rritur në Xhafzotaj të Durrësit sapo kishte mbaruar shkollën fetare të Medresesë "Mustafa

Në profilin e saj në rrjetin social "facebook" bie në sy numri i lartë i dedikimeve dhe poezive që Ajshe Vata i ka kushtuar nënës së saj të cilën e ka humbur në vitin 2006.

Varoshi" në Durrës. Këtë vit ajo kishte konkuruar në Tiranë për degën e infermierisë të cilën e kishte fituar dhe priste të zhvendosej në kryeqytet për të filluar më-

simin. I ati i saj Muhamet Vata është pronari i një servisi automjeteve të cilin e kishte fare pranë vilës së tij ndërsa Ajshe Vata shpesh herë shkonte dhe ndihmon-te të atin gjatë punës së tij. Në profilin e saj në rrjetin social "facebook" bie në sy numri i lartë i dedikimeve dhe poezive që Ajshe Vata i ka kushtuar nënës së saj të cilën e ka humbur në vitin 2006. Përveç "fiksimit" ndaj figurës së nënës së humbur Ajshe Vata rezultoi dhe shumë e dhënë pas mësim-eve dhe thënieve të fesë islame. Një tjetër pikë e dobët e 18 vjeçares ka qenë vëllai i saj 6 vjeçar Emeli. Madje edhe emrin e saj në "facebook" ajo e ka shkruar: Ajshe Vata(Meli). Vëllai i saj 6 vjeçar ka lindur vetëm dy javë para se nëna e saj të humbte jetën, madje siç tregojnë fqinjët arsyeja e vdekjes së nënës së Ajshe vatës ka qenë komplikacioni që i solli lindja e djalit të saj.



Në foto: Policia në vendin ku u gjet trupi i Ajshe Vatës

DURRES

HABJON HASANI

Besim Lame është punonjës i hekurudhës me funksionin roje kalesë, ndërsa punën e ka fare pranë vilës së Muhamet Vatës, babait të Ajshe Vatës. Mëngjesin e djeshëm ai ka shkuar si çdo ditë normalisht në punë por krejt papritur ai është bërë njeriu që ka informuar i pari policët në lidhje me krimin makabër të ndodhur në Xhafzotaj të Durrësit dhe një ndër njerëzit e parë që ka marrë vesh atë që kish-te ndodhur.

Zoti Lame në ç'rret-hana e keni njoftuar policinë në lidhje me trupin e gjetur këtu në Xhafzotaj?

Unë punoj këtu roje te hekurudha në kalesë. Sot(dje) në mëngjes ndërsa po rrija këtu te kabina shof që po vinte me vrap drejt meje Sabri Balla veti i dytë sëbashku me një njeriun e vetë. Më thirri në emër sepse unë e njof Besim Ballën dhe më tha t'a ndihmoja se nuk kishte telefon. I thashë çfarë ka ndodhur dhe në këtë moment më tregoi se në tokën e tij bujqësore kur kishte shkuar kishte gjetur trupin e një femre me kokën e prerë. Më tha që të merrja menjëherë policinë dhe numrin 129. Menjëherë me telefonin tim kam marrë policinë dhe

Flet dëshmitari, personi që njoftoi policinë


Besim Lame: Si e gjetëm trupin e Ajshe Vatës

Pronari i tokës njoftoi punonjës in e hekurudhës



Në foto: (majtas) Dëshmitari Besim Lame duke folur për Shqiptarja.com

(djathtas) Vëllai i vogël i Ajshe Vatës në ambientet e brendshme të vilës



Telefonata

Më tha që të merrja menjëherë policinë dhe numrin 129. Menjëherë me telefonin tim kam marrë policinë dhe u tregova atë që më tha Sabriu.

te kalesa e hekurudhës dhe më pas Sabriu i ka shoqëruar për te toka e tij.

Sabriu është fqinj i familjes Vata?

Jo, Sabriu ka tokën në pronësi anës hekurudhës dhe toka e Sabriut është nja 500 metra larg shtëpisë së Muhamet Vatës. Sabriu vetë jeton në "4

rrugët e Shijakut" por vjen herë pas here te tokat e veta.

Juve u pyetët nga policia?

Jo unë nuk jam pyetur por Sabriun kanë pyetur në fillim këtu në Xhafzotaj në lidhje me rrethanat se si e kishte gjetur trupin. Sabriu është i moshuar dhe ka qenë shumë i tronditur.

Vetëm si fytyrë dhe që ishte goca e Muhametit. Ka qenë një vajzë që ishte veç shkollë dhe shtëpi. Muhameti çdo mëngjes e shoqëronte vetë me makinë deri te furgonat që nisheshin për në medresenë e Durrësit. Ishte vajzë e urtë shumë.

Ka patur konflikte familja apo ndonjë hasmëri të trashëguar?

Nuk di të kenë patur asnjë lloj konflikti ata. Nëse do kishin hasmëri do e dinim. Muhameti ka qenë njeri shumë familjar dhe shumë punëtor. Në vitin 2006 i ka vdekur bashkëshortja e parë dhe ka vuajtur shumë me të pasi kishte një sëmundje të keqe. E çoi edhe në Turqi për ta kuruar por nuk mundi dot

Kur e morët vesh se trupi ishte i Ajshe Vatës?

E mora vesh se erdhi dhe ma tha një banor këtu afër.

Sa ishte ora kur mës-ove se trupi ishte i Ajshe Vatës?

Ka qenë jo më shumë se gjysmë ore pasi policia shkoi te arra ku ishte trupi i gjetur nga Sabriu. Ka ardhur një fqinj i Muhametit dhe ma tha se Muhameti i kishte thënë se çupën ja kishin vuarë, pastaj pamë dhe shumë makina policie që u mbledhën te vila e tij aty te shtëpia. Më vonë policia i mori të gjithë antarët e familjes dhe i çoi në Durrës se do i pyesin.



Shtëpia ku banon familja e Ajshe Vatës

E njeh personalisht Muhametin?

Po e njoh se unë kam vite këtu që punoj për hekurudhën dhe ai ka servis in me makinave pak më lart. Përshendetshim dhe flisnim shpesh me njëri tjetrin.

të jetonte. Muhamet Vata ka qenë një ndër njerëzit më model në këtë pellgun këtu, përgjithësisht në këtë zonë njerëzit janë shumë paqësorë dhe në punë të tyre por Muhameti ka qenë i matur, punëtor dhe i respektuar më shumë se të tjerët.

Po Ajshe e njihje?

Fqinja



"Ishte e urtë, jetonte me njerikën"

M.U. është një 14 vjeçare e cila e ka shtëpinë e saj fare pranë vilës ku banonte Ajshe Vata.

Ju e njihni Ajshe Vatën?

Po e njoh sepse jemi fqinj.

Kur e morët vesh atë që kishte ndodhur?

Mua ma tha një shitëse dyqani kur u ktheva nga shkolla. Jam e shokuar.

Bisedoje shpesh me Ajshe?

Jo, unë jo. Jam dhe më e vogël. Ajo nuk ishte tip që bisedonte shumë me njerëzit dhe këtu në lagje nuk ka patur shoqe. Më shumë e shikoj kur përshëndeteshim dhe kur ndihmonte të atin te servisi. I ka vdekur e ëma përpara disa vitesh në vitin 2006 dhe më pas i ati u martua sërisht dhe Aishja jetonte me njerikën. Ishte shumë e urtë. Njeri që nuk përziej me të tjerë shikon-te punën e saj. Katër vite rresht shkante në Durrës se aty e ka bërë gjimnazin në një shkollë fetare dhe kam dëgjuar se ajo tani afër kishte fituar edhe të drejtën e shkollës për t'u bërë infermiere. E fitoi në Tiranë shkollën dhe tani afër do ikte për të filluar.

MËSUES DHE NXËNËS TË MEDRESËSË SË DURRËSIT KOMENTUAN DJE NË "FACEBOOK" VDEKJEN E TMERRSHME TË AJSHËS





Shëndeti, Lirak Bejko në gjendje të rëndë, përmirësohet Ndreca

Lirak Bejko, grevisti i dytë, i cili i vuri flakën vetes të mërkurën vazhdon të jetë në gjendje të rëndë shëndetësore. Burime pranë repartit të djegie-plastikës ku edhe po merr ndihmën e specializuar Bejko, mësohet se gjendja e tij shëndetësore vazhdon të jetë në parametra të stabilizuar, por që nuk ka ndryshim nga një ditë më parë kur edhe

erdhi në spital. Mjekët shpjegojnë se gjatë ditës së djeshme Bejko ka nisur trajtimin me antibiotikë, ndërsa gjatë ditës së sotme pritet që t'i bëhen disa ekzaminime të tjera për të parë se si ka reaguar plaga. Ata shprehen optimistë për faktin se deri më tani plagët e shkaktuara nga flakët nuk kanë krijuar infeksion, një shenjë e mirë kjo për ecurinë e kurës së pacientit.

Lirak Bejko tentoi dy ditë më parë t'i vinte flakën vetes me benzinë, dhe si pasojë pësoi djegie të rënda në 50 përqind të trupit. Ndërsa sa i përket Gjergj Ndrecës, grevisti tjetër që tentoi të vetëdijegje, ai tashmë është jashtë rrezikut për jetën dhe ka rikuperuar një pjesë të mirë të plagëve që ka marrë në këtë akt ekstrem vetëflijimi.

AK në mbështetje të grevistëve, djeg fotot e Berishës

Greva, tenton vetëflijimin ish i burgosuri i tretë

Policia e pengon, Gani Aliaj: Gjithësesi, do vetëvritem

Lajmi


Gani Aliaj, një ish i burgosur politik, por që nuk është pjesë e grevës së urisë ka tentuar mbrëmë rreth orën 19:30 të vetëflijohet pak metra para çadrës ku po zhvillohet greva e urisë. Ai është lyer me benzinë, por është pikasur nga uniformat blu që ruajnë zonën dhe është ndaluar në momentin e fundit.



Gani Aliaj

"20 vjet burg, 20 vjet burg, 20 vjet burg në Spaç si qeni, nuk kam marrë asnjë lekë. Doni me më vra, më mbysni. Do vras veten dhe po ika që këtej do hidhem nga pallatet"

Në foto: Protestuesit e AK duke djegur fotot e Berishës



shprehur se i mirëpresin akte të tilla. "Gani Aliaj është një i përndjekur politik i mirëfilltë dhe ne e mirëpresim këtë reagim, mirëpresim reagime të tilla. Këmbanat po bien, kryeministri po na qesh. Unë po i them kryeministrit se këta njerëz që sheh ti këtu janë drejt falimentimit, por do t'i them mblidhëni mendjen zoti kryeministër se do të arrijnë përsëri në atë gradë siç kanë arritur të tjerat" - ka deklaruar Patrioti.

PROTESTA

Gjatë mesditës një grup aktivistësh të aleancës Kuq e Zi kanë djegur posterat e kryeministrit Berisha para Parlamentit në mbështetje të grevës së ish të burgosurve politikë. Aleanca Kuq e Zi iu bashkua protestës së planifikuar të zhvillohej sot para parlamentit. Për gati 30 minuta ish të burgosur politikë, të mbështetur nga AK e sindikata tjera protestuan sot përpara parlamentit. Ndërkohë, vetëm disa

minuata pasi ka përfunduar protesta u arrestuan 7 aktivistët e AK-së, informon AK. Sipas kësaj partie aktivistët u morën me dhunë në komisarjat në rrugën e Durrësit dhe Kavajës. Ata thonë se aktivistët u arrestuan nga policë të veshur civilë të cilët shkaktuan panik edhe te qytetarët. "Po digjen njerëz të gjallë dhe po arrestohen qytetarë të këtyre vendit të cilët në zbatim të ligjeve të vendit po protestojnë për situatën dramatike në të cilën ndodhet

Kundërshtarët nuk arrijnë të kuptojnë pse Gani Aliaj është një i përndjekur politik i mirëfilltë dhe ne e mirëpresim këtë reagim, mirëpresim reagime të tilla ajo u bë murgeshë në vitin 1928

vendi ynë" - deklaroi kreu i AK-së, Kreshnik Spahiu, në një deklaratë për shtyp.

TIRANE

ESMERALDA KETA

Duket se 50 vjeçari me origjinë nga Tirana, ka qenë i vendosur për aktin ekstrem që ka ndërmarrë mbrëmjen e djeshme. Ndonëse është ndaluar nga policia ai ka deklaruar se gjithësesi ai do të vetëflijohet, pasi nuk ka marrë asnjë lekë nga paratë e dëmshpërblimit që i takojnë. Aliaj është futur te rrugica ku po zhvillohet greva, ka nxjerrë shishen me benzinë, dhe ndërsa tentonte të spërkaste veten është pikasur nga uniformat blu që i janë hedhur përsipër, e kanë shtrirë në tokë dhe tentonin t'i mbyllnin gojën. "Unë kam bërë 20 vite burg në Spaç, - thërriste Aliaj, tekta forcat e shumta të policisë e kishin shtrirë në tokë duke e penguar t'i vinte flakën vetes, - Kemi jetuar si qeni dhe deri më tani nuk kam marrë asnjë lek. Edhe nëse më ndaloni këtu, unë do të vras veten diku tjetër. Do të shkoj të hidhem nga një pallat", - kanë qenë këto fjalët e ish të burgosurit Aliaj, që mësohet se iu bashkua në mënyrë vullnetare thirrjes së grevistë për të vijuar listën e vetëflijimeve, si përgjigje ndaj heshtjes totale të qeverisë shqiptare ndaj grevës së tyre, që kërkojnë dëmshpërblim për vitet e burgut. Më pas Aliaj është shoqëruar për në

komisarjat. Ngjarja që ka ndodhur pak metra larg çadrës ku po zhvillohet greva e urisë, ka bërë që edhe mbështetësit e tjerë të grevës së ish të burgosurve politikë të largohen nga çadra për të zgjeruar rrethin e ndodhës së ngjarjeve të tilla ekstreme. "Sapo u njohëm më një akt tjetër të Gani Aliajt. Edhe pse nuk ishte në grevë ka bërë një veprim sporadik, për t'u solidarizuar me të burgosurit politik dhe vëllezërit e tij. Ai nuk e bëri aktin, por veprimi që bëri ai ishte të më sintonizoi të atyre që kanë deklaruar të burgosurit politik se do të vetëflijohen nëse nuk do të marrin përgjigje nga qeveria. Siç ndodhi sot në mënyrë të pakontrolluar, mund të ndodhi në një vend tjetër nga dikush tjetër, prandaj i bëj apel qeverisë që të ulet sa më shpejt dhe t'i japë të drejtën legjitime këtyre

njerëzve. Nuk kërkojnë asgjë por zbatimin e ligjit. Mos u tall nëpër parlament zoti kryeministër, po i jepni të burgosurve politik atë që i ka dhënë legjislacioni shqiptar. Nuk është një këst siç thuat ti, por janë 4 këste", - ka qenë kjo thirrja që i ka bërë kryeministrit të vendit, Skënder Tufa, koordinator i grevës së urisë. Ndërsa Asllan Patrioti, kryetar i ish të përndjekurve politik, dega Durrës është

Besim Ndregjoni:

"Kjo qeveri komuniste s'na dëmshpërblen"

TIRANE

Sekretari i përgjithshëm i Shoqatës S'mbarëkombëtare të Integritimit të të Burgosurve dhe të Përndjekurve politikë, Besim Ndregjoni ka komentuar grevën e ish-të burgosurve politikë, duke deklaruar se një qeveri e tillë me përbërje komuniste nuk e dëmshpërblen këtë shtresë. "Ne kërkojmë zbatimin e nenit 45 të Kushtetutës, që thotë qartë e prerë, se çdo shtet që ka dëmtuar qytetarin për arsye politike ka të drejtë ta dëmshpërblejë atë ose shkel të drejtat dhe liritë themelore të tij. Në zbatim të ligjit për dëmshpërblimin dhe statusit të ish të burgosurit politik, që kanë përfutur pajfajësinë më 1991, duhet të realizohet



Besim Ndregjoni

dëmshpërblimi", deklaroi Ndregjoni për gazetën. Ai ka shpjeguar dhe arësytet e vetëflijimit të ish-të burgosurve. "Ata kanë hyrë në grevë urie që persekutoret e djeshëm të mos jenë në drejtimin e shtetit shqiptar, duke filluar nga Kryeministri, Presidenti e deri te më thjeshti në drejtim në ministri. Sot të përndjekurit politikë shohin në instancat më të larta të shtetit shqiptar persekutoret e tyre të djeshëm. Sot të persekutuarit shohim persekutoret e tyre të djeshëm duke marrë pensione të majme dhe ky shtet i ashtuquajtur demokratik u jep pensione qesharake ikonave të qëndresës ndaj diktaturës", nënvizoi Ndregjoni. I cili këmbëngul që sot ata që kanë hyrë në

grevë urie duan që çdo politikan shqiptar të hapë dosjen e tij përpara se të zhvillojë rrugën politike, që të ketë kartën morale përpara shoqërisë. "Greva e urisë është një grevë ligjore e cila përballet me një president jo ligjor e urrejtës ndaj të përndjekurve politikë, përballet me një Parlament jo ligjor por përbuzës të përndjekurit politikë, përballet me një qeveri jolegjitime përballet të përndjekurve politikë", tha Ndregjoni. I cili tha se i janë bashkuar grevës, pavarësisht se në Shqipëri diktohet lëvizja qytetare. "Greva e urisë s'është grevë individësh, por një grevë ligjore e atyre që ju janë shkelur të drejtat qytetare që u janë garantuar me ligj por që s'ju jepen", - thotë Ndregjoni.



Edi Rama: Po tentojmë që Ndrecën dhe Bejkon t'i dërgojmë jashtë

Gjergj Ndreca dhe Lirak Bejko, dy ish-të përndjekurit që tentuan vetëflimimin, mund të kurohen jashtë vendit. Zyra e shtypit e Partisë Socialiste bën me dije se pas interesimit të kryetarit Edi Rama, do të tentohet që nesër ata të dy të transportohen drejt Greqisë dhe Italisë për një trajtim më të specializuar në qendrat e dëgjiejeve. Burime nga Partia

Socialiste thanë se kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama është interesuar gjatë ditës së djeshme për mundësinë e kurimit të dy ish të përndjekurve grevistë, aktualisht duke u kuruar në spital nga djegiet, jashtë Shqipërisë. Burime nga Partia Socialiste bëjnë të ditur se ditën e sotme dy ish të përndjekurit do të tentohet të transportohen drejt Italisë dhe Greqisë

në qendra të specializuara dëgjieje. Dy grevistët, Lirak Bejko dhe Gjergj Ndreca, i vunë flakës vetes, si reagim ekstrem ndaj indiferencës së qeverisë për grevën e tyre. Ata kërkojnë që të marrin paratë e dëmshpërblimit që u takojnë për vitet e burgut, por kreu i qeverisë, Berisha, e ka injoruar këtë grevë duke e quajtur atë grevë politike.



Në foto: Policia duke ndaluar Gani Aliajn, i cili tentoi mbrëmë të vetëdijgjij pranë çadrës së grevës së urisë. Ai nuk është pjesëmarrës në grevën e urisë.

FOTO "A1 REPORT"

Shoqërimi

I vuri flakën Ndrecës, lihet i lirë Shqevi

■ ■ ■ TIRANE

Lihet i lirë grevisti Perikli Shqevi, i cili vuri flakën Gjergj Ndrecës. Në seancën gjyqësore për vlerësimin e masës së sigurisë prokurori i çështjes ka kërkuar arrest shtëpi për Perikli Shqevin. Sipas përfaqësuesit të akuzës në momentin që Ndreca kërkonte shprehësin në xhep për t'i vënë flakën vetes, Shqevi e ka ndezur me çakmak, duke konsumuar veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje. Ndërsa mbrojtësi i Shqevit e ka cilësuar arrestimin si të paligjshëm. Në sallën e gjyqit mbrojtësi është shprehur se Shqevi është shumë shok me Ndrecën dhe duhet të lihet i lirë nga gjykata. Pas një pauze prej 15 minutash gjykata ka caktuar masën e sigurisë arrest shtëpie për grevistin Perikli Shqevi, duke u shprehur se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën e ngri-



Perikli Shqevi

tur nga ana e Prokurorisë. Pas përfundimit të seancës gjyqësore grevisti Perikli Shqevi është shoqëruar për në banesën e tij, e cila është në afërsi të vendit ku po zhvillohet greva e urisë së ish-të përndjekurve politikë. Banesa e Shqevit ruhet nga një postbllok policie

prej tre efektivësh, të cilët janë pozicionuar duke mos lejuar afrimin e asnjë personi afër banesës. Vetë Perikli Shqevi i pyetur nga ana e uniformave blu mohoi akuzën, duke u shprehur se ai ishte një nga personat që iu afrua me batanije Gjergj Ndrecës për ta shpëtuar nga flakët. Burime të policisë së Tiranës thanë se Shqevi, i identifikuar nga policia edhe me emrin Pal Shtejfni, mbajti të njëjtin qëndrim mohues edhe kur atij i është bërë e ditur se veprimi i tij është filmuar nga një kamera e televizionit 'A1 Report'. "Nuk është e vërtetë që unë i kam vënë zjarrin Gjergjit. Unë i çova një batanije për ta ndihmuar", ka thënë Shqevi edhe pasi është ballafaquar me pamjet filmike. Në to duket se Perikli Shqevi i afrohet Gjergj Ndrecës dhe personave që mundohen të bllokohen atë për t'i vënë flakën vetes, ndërsa ai thërri: "Më vini shprehësin"! Në këtë moment Shqevi zgjat dorën, ndërsa trupi i Ndrecës përfshihet nga flakët. **an. ta.**

REPORTAZH/ Çfarë ndodhte dje në çadrën e blinduar nga forcat e rendit

60 policë ruajnë 11 grevistë

Në çdo turn janë rreth 20 uniforma blu, një patrullë prej 7 personash është e komisarariatit nr.1 dhe 13 të tjerë janë të drejtorisë së policisë së Tiranës. 2 të tjerë te shtëpia e Shqevit

■ ■ ■ TIRANE
ESMERALDA KETA

Zgjerohet edhe më shumë perimetri rreth të cilit mund t'i afrosh çadrës ku po zhvillohet që prej 21

ditësh greva e urisë e ish të burgosurve politikë. Nëse gjatë ditës së djeshme kordoni i policisë kishte rrethuar vetëm zonën rreth çadrës, pas incidentit të mbrëmshëm, ku një tjetër ish i burgosur tentoi t'i vinte flakën vetes para kordonit të policisë, tashmë

askush nuk lejohet të futet as në mërkurë, çadra ku po zhvillohet greva e urisë së ngujimit.

SITUATA

Duke filluar që nga dita e mërkurë, çadra ku po zhvillohet greva e ish të burgosurve politikë është blinduar nga forca të shumta policie. Mësohet se për ruajtjen e kësaj çadre është vënë në dispozicion një patrullë për çdo turn nga komisaritati numër 1 i policisë në kryeqytet. Një patrullë përbëhet nga deri në 5-7 persona, pasi shkojnë edhe përforcime, ndërsa janë edhe dyfishi i kësaj patrulle nga drejtoria e policisë së kryeqytetit, që në total bëjnë rreth 20 uniforma blu për çdo turn. Që do të thotë se brenda 24-orëshit, janë të angazhuar plot 60 uniforma blu që ruajnë 11 grevistët të mos ndërmarin ndonjë akt tjetër ekstrem të vetëflimimit. Gjithashtu mësohet se ata që ruajnë çadrën janë kryesisht të drejtorisë së policisë së Tiranës, për arsven se ata janë efektivi më të specializuar për mbajtjen nën kontroll të situatave që kanë prioritet, ndërsa patrulla e komisarariatit nr.1 qëndron në hyrje të rrugicës. Uniformat e policisë që kanë blinduar këtë zonë, jo vetëm që kanë kontrolluar brenda në



Çadra ku po zhvillohet greva e urisë dhe që ruhet me policë

çadrë, por u kanë bërë një skaner të imtësishtë edhe të gjithë personave që janë afruar për të takuar grevistët, me frikën se mos ndonjëri prej tyre tenton të fusë ndonjë shishe benzinë. Ndërkohë që ngjitur me grevën e urisë, ndodhet edhe shtëpia ku banon Perikli Shqevi, i cili gjatë ditës së djeshme u la në arrest shtëpie, dhe dy policë qëndrojnë në hyrje të shtëpisë së tij. Megjithatë ish të përndjekurit komunikojnë vazhdimisht me Shqevin nëpërmjet dritares, por pa mundur t'i afrohen atij.

GREVA

Aktualisht në grevën e urisë ndodhen të ngjuar 11 grevistë. Gjatë ditës së djeshme është dërguar në spital njëri prej tyre, pasi situata e tij shëndetësore është rënduar së tepëri, por gjithashtu i është rikthyer asaj Agim Kollçaku, grevisti tjetër që u dogj tekta tentoi të shuante flakët që përfshinë Lirak Bejkon. Ndërkohë që dy grevistë janë të shtuar të djegia plastika, 4 të tjerë janë nëpër pavijone të ndryshme në QSUT, ndërsa një tjetër ndodhet i shtuar te kardiologjia për shkak të problemeve serioze që ka pasur me zemrën.



Shtëpia e Perikli Shqevit

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARAT-EVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- ☞ Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- ☞ Marjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brenda dy ditëve.
- ☞ Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- ☞ Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



Kuvendi blindohet nga policë, Fyle: Qeveria të kompesojë të përndjekurit

Institucioni i Parlamenti u blindua dhe nga forca të shumta policie. Ndërkohë që para fillimit të seancës së djeshme plenare, përpara Parlamentit për gati 30 minuta protestuan ish të burgosurit politikë të mëshetur edhe nga Aleanca Kuq e Zi e sindikata të tjera që mëbstesin këtë kategori, forca të shumta policie rrethuan deri në përfundim të seancës gjithë

institucionin ligjvënës. Frika se ish të dënuarit politikë mund të mësynin në Parlament, ka bërë që çdo javë ky institucion të mbrohet nga forca police që sa vijnë dhe shtohen në numër. Ndërkohë që lidhur me grevën e urisë që kanë ndërmarrë një grup ish të dënuarish politik, dje reagoi dhe komisioneri për zgjerimin europain, Stefan Fyle. Ai deklaroi se zgjidhja e vetme është

kompensimi i këtyre nga ana e qeverisë. "Mendoj se elementi bazë i këtij respekti është që, nëse kompensimi është premtuar dhe është kthyer në ligj, ky ligj duhet të zbatohet. Zbatimi është problem dhe unë shpresoj që qeveria të vendosë rregull në punët e shtypës" në veçanti për këtë çështje. Unë mendoj se ata duhet të trajtohen me respekt", tha Fyle.

Debatet në Kuvend për grevën e ish-të përndjekurve

Grevistët, Berisha: Benzinën ua çoi PS

PS: Po injoroni shtresën që ju dha votat

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Seanca e djeshme plenare u kthye në një arenë debatesh mes kryeministrit Sali Berisha dhe deputetëve të opozitës përpara i përkatësit aktualitetit në vend lidhur me grevën e urisë që kanë ndërmarrë ish të përndjekurit politik. Opozita i kërkoi Berishës që të dialogojë me grevistët, ndërkohë që me tone të ashpra nga ana e tij këru i qeverisë nuk nguroi që të lëshojë akuzat të rënda mbi opozitarët, se janë ata që i kanë shtyrë grevistët drejt aktit të vetëflijimit. Ai tha se janë pikërisht socialistët ata po përdorin këtë shtresë të popullsisë, duke shtuar këtu se ata kanë dërguar shisheet me benzine në çadrat ku janë ngujuar grevistët. "Unë ju them ju që të mos çoni shisheet benzine, iu bëj thirrje familjarëve të tërheqin familjarët e tyre nga greva. Kërkoj rikthimin e ligjit të lustracionit, që ju e votuat kundër. Ndihmohuni ju, jepuni gjysmën e rrogës. Bëhuni humanistë. Thuajini Fidelit tu japë apartamente", iu është drejtuar dje Berisha opozitarëve.

REPLIKA MAJKO-TOPALLI

Replika të ashpra janë zhvilluar dje mes kryetares së Parlamentit Jozefina Topalli dhe ish kryeministrit Pandeli Majko. Ndërkohë që Majko po i bënte apel qeverisë që të uljet negociatën me ish të përndjekurit, Topalli konsideroi Majkon një të paedukuar që paragonon orgjinën e saj. Ajo iu drejtua Majkos që të kërkonte falje që nuk i kishte dëmtsh-përbyer të dënuarit kur kishte qenë në pushtet. "Ju që keni qenë kryeministër në qeveri gjatë 8 viteve pse nuk i dhatë asnjë lekë, asnjë burs, asnjë të drejtë studimi? Pyetje e thjeshtë, por që të bën të turpërohet. Ti i pari që je aty dhe pastaj të gjithë shokët e tu të tjerë. Nuk po flas për partinë nënë tënde që i pushkatoi, i burgosi, i dhunoi, i internoi. Kërko të

Lajmi

Parlamenti është përfshirë dje në akuzat të ashpra mes palëve, ku "molla e sherrit" ishte pikërisht greva e urisë nga ish të përndjekurit dhe akti i vetëflijimit të tyre. PD akuzon opozitën se përdor dhe nxit grevistët, ish të përndjekurit drejt këtyre akteve.

falur për krimet e partisë tëndë nënë. Se burri ka mundësi të turpërohet deri në ditën e fun-

dit të jetës", tha Topalli. Në kundërpërgjigje të tij, Majko tha se kjo nuk është grevë e PS, është

të grevë e një shtrese që i ka mbajtur mbi supë.

BALLA BREGUT: ARROGANTE

Deputeti i PS, Taulant Balla tha dje se ministria e Integritimit Majlinda Bregu është kondisuar arrogante nga ish eurodeputet. "Flasim për ministrin ku një eurodeputet e cilësoi arrogante. Po të ishte për familjen Bregu do të hapeshin dosjet e



DEBATET DJE NË PARLAMENT

Pandeli Majko: Pavarësisht nga tempi entuziast e ministres së Integritimit, unë do të doja që dje (të mërkurën) të ishte një ditë e lumtur dhe për një shtresë tjetër, por nuk ndodhi. Ishte një ditë e zymtë para se të shikonim shkëlqimin e flakës në qiell, pamë një shkëlqim tjetër. Pamë shkëlqimin e zjarrit në trupin në trupin e një grevisti. Qeveria u çon ministrin e Shëndetësisë për t'i thënë që do shëroheni dhe nuk u çon përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë. Dhe ç'është më e keqja, i nxjerr përfaqësuesit në konferencë shtypi për t'u thënë se edhe kaq sa keni marrë, shumë e keni. Deklarimet e kryeministrit se kjo është një grevë politike, janë një përrallë. Mund të digjen për gjithë ata grevistë, por për PS nuk bën vaki. Ajo është një grevë ekonomike e njerëzve dinjitozë.

Jozefina Topalli: Mbaroi koha zoti Majko, faleminderit.

Erjon Braçe: Lëreni të flas moj zonjë.

Jozefina Topalli: Unë nuk të bëj pyetje, ju që keni qenë kryeministër në qeveri gjatë 8 viteve pse nuk i dhatë asnjë lekë, asnjë burs, asnjë të drejtë studimi? Pyetje e thjeshtë, por që të bën të turpërohet. Ti i pari që je aty dhe pastaj të gjithë shokët e tu të tjerë. Nuk po flas për partinë nënë tënde që i pushkatoi, i burgosi, i dhunoi, i internoi. Kërko të falur për krimet e partisë tëndë nënë. Një kryeministër që u ka dhënë zero lekë duhet të turpërohet sot ose të paktën kërko të falur. Se burri ka mundësi të turpërohet deri në ditën e fundit të jetës. Je ish kryeministër.

Pandeli Majko: Po e filloj nga ajo që lokja e Parlamentit më kërkoi.

Jozefina Topalli: Ty të të vijë turp, por kjo është edukata jote.

Pandeli Majko: Po vazhdoj.

Jozefina Topalli: Jo nuk të lë të flasësh. Njëqoftë se qenia ime nga Shkodra të duket ashtu siç e the po ta them ty dhe të gjithë të tjerëve, unë jam nga Shkodra dhe jam krenarë 1 mijë herë që jam nga Shkodra. Nuk kanë të sosur hipokrizitë e tua. Kërko të falur. Pse nuk po gjen një fjalë për marrjen e statusit o zoti ish-kryeministër?

Pandeli Majko: Falja nuk është vetëm një fjalë. Falja është shumë më e thellë se sa shprehja "më fal". Është e vërtetë që unë kam qenë kryeministër dhe nuk kam bërë ndonjë gjë të madhe për ta.

Jozefina Topalli: Ju nuk keni bërë asgjë ato që ishin me ligj. Thoni të vërtetën.

Pandeli Majko: Çdo qytetar e di se në ç'kushte kam qeverisur unë. Nuk ka qenë vendi kaq i qetë sa sot. Ajo që doja të them është e thjeshtë. Negocioni, mos i çoni ministrin kur ata i kanë vënë flakën vetes. Nuk është grevë e PS, është grevë e një shtrese që u ka mbajtur mbi supë. Shqipëria sot qeveriset nga punonjësit e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit. Ky është fakt.

Jozefina Topalli: Ti nuk e fshet dot marrjen e statusit me hipokrizinë dhe gënjeshtret e sotme (e djeshme). Shumë të mërzhitur jeni ju nga marrja e statusit. Kërkoji të falur që e bllokuat statusin për dy vjet.

Pandeli Majko: Ajo që po kërkoj sot është një lloji negociate për ata njerëz që ndodhen në kushte të vështira. Mos i lini ata njerëz të digjen.

Jozefina Topalli: Faleminderit z. Ish-kryeministër. Mund të mbushet mendja për të folur 8 orë, dil jashtë në media dhe fol. Kam shkelur rregulloren. Kaluan 10 minuta.

Erjon Braçe: Po atë zonjën ministre që nuk e ndërpreve?

Sali Berisha: Ju jeni sulur me tërbim kundër forcave ushtarake të vendit. (Taulant Ballës: Zotëri ti e di atë historinë e kalimit të kufirit me zotin Isuf. Vazhdon dhe do vazhdojë të ndiqet ai. Por e vëreta është se do jesh ti i dyti pas tij. Ke përdorur pasaportën tënde diplomatike për të shpëtuar trafikantin e drogës. Ne i kemi respektuar dhe i respektojmë ish të përndjekurit. Deri më sot janë dhënë mbi 100 milionë dollarë. Grupi që bën grevën politike ka marrë mbi 256 mijë dollarë dhe nuk kam llogjitur këtu 4 apartamente që iu janë dhënë. Atji që iu vu flaka nga kauza juaj, ai zotëria i ndëruar me paratë që mori, privatizoi fabrikën e miellit në qytetin e Laçit.

Sajmir Tahiri: Ore se dhe ti komunist je, sekretar partie ke qenë 20 vite.

Sali Berisha: Unë ju them ju që të mos çoni shisheet benzine, iu bëj thirrje familjarëve të tërheqin familjarët e tyre nga greva. Kërkoj rikthimin e ligjit të lustracionit, që ju e votuat kundër. Ndihmohuni ju, jepuni gjysmën e rrogës. Bëhuni humanistë. Thuajini Fidelit tu japë apartamente. Sa tua japë ju, tua japë atyre. Le të japë Fidelit 5 se nuk e gjen gjë.

Jozefina Topalli: Po z.Ruçi keni fjalën. Ruçi do flasë për të persekutuarit. Z.Ruçi si ministër i fundit i Brendshëm i komunistëve.

Gramoz Ruçi: Sado cinike të jeni me mua, më lejoni të shprehem. Unë nuk do bie në të njëjtin gabim. Ju zonja kryetare, që jeni aty edhe pse vini nga një shtresë e persekutuar, është e pafalshme për ty që publikisht kur të pyet gazetari se ç'mendim ke, të thuash s'kam koment. Si s'ke koment për ata dhe paske koment të anatemosh këdo nga ne. Shko atje se i bën nder vetes tënde, prejardhjes tënde, karriges në të cilën të kanë zgjedhur, votës që të kanë dhënë. Pse druhen? Pse trembesh? Ata janë burra. Nuk vënë dorë, jo e jo mbi gratë, por mbi asnjë shtetar.

Astrit Patozi: Ju sot keqpërdorët sepse folët në emër të atyre që i keni përburuar. Shkuat t'i vizitoni, Z. Majko, por keni qenë kryeministër në buxhete ku nuk ka pasur as edhe një kacidhe për ta sepse për ju ata nuk ekzistojnë. Janë fshirë nga lista.

Taulant Balla: Të burgosurit politikë janë të detyruar që të negociojnë më një sekretar partie. Sali Berisha ka 24 vjet anëtar partie dhe guxon e tallet me burgun e tyre, u premtoi lëmosh. Tu japë Saliu tokën që dhëndri i vetë dhe Arben Ilami e kanë gllabëruar, në qendër të Tiranës. Flasin për ministrin ku një eurodeputet e cilësoi arrogante. Po të ishte për familjen Bregu do të hapeshin dosjet e Sakra Corona Unitës dhe Shqipëria jonë do të ishte larg statusit të vendit kandidat. Saliu po sillet si pushtues. Vetëm një spiun serb si Sali Berisha mund të jepte një bazë ushtarake për 23 milionë lekë të vjetra.



Kuvendi do shyrtojë ligjin për përgjimet e telekomunikimeve

Konferenca e Kryetarëve ka miratuar edhe kalendarin tre javor të punimeve në Kuvend, ku në rend është përfshirë dhe projektligji për përgjimin e telekomunikimeve. Lidhur me këtë ligj, Partia Socialiste ka shprehur qëndrimin e saj se nuk do ta votojë, pa u shqyrtuar më parë dhe amendamentet që ajo do të propozojë për një një projektligj kaq të rëndësishëm që prek komunikimin

personal përveç telefonave, por edhe komunikimin me postë elektronike. Ndërkohë një element i rëndësishëm që është ndryshuar nga ligji i vjetër, ka të bëjë me autorizimin e Prokurorit të Përgjithshëm për të dhënë leje për përgjim, autorizim të cilin më parë e kishte SHISH. Pritet që ky projektligj të diskutohet në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, në Komisionin e Ligeve si dhe atë të

Veprimtarive Prodhuese. Ndërkohë që në rend të punimeve të Kuvendit është përfshirë dhe një tjetër projektligj që ka të bëjë me një marrëveshje të tretë për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë. Bëhet fjalë pikërisht për shtimin e afatit të shlyerjes së kredisë prej 12 milionë euro të marrë nga vedit ynë nga Banka Europiane e Investimeve për këtë projekt rrugor.

Opozita bojkoton votimin e kreut të KQZ, voton vetëm anëtarët

PD zgjedh Lefterie Lleshin kryetare të KQZ

Dule bashkon votën me PD, voton për Lleshin

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

A shtu siç pritej, kreu i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve u vendos vetëm nga votat e deputetëve të mazhorancës në Kuvend. Pas procesit të votimit në mënyrë të fshehtë, u arrit që me 72 vota pro, të deputetëve të Partisë Demokratike si dhe votën e Vangjel Dules nga grupi opozitar, në krye të institucionit që do të administrojë zgjedhjet e ardhshme u zgjodh të jetë pikërisht Lefterie Lleshi. Ndërkohë që të pranishëm në votimin e djeshëm, deputetët e Partisë Socialiste i kanë qëndruar vendimit të tyre të grupit se nuk do të votonin kandidatët për kryetar të KQZ. Këtë qëndrim të matët e kanë deklaruar që në përzgjedhjen e dy emrave që do të garonin për këtë post, pasi sipas tyre këto ishin figura politike. Ata kanë marrë pjesë vetëm në votimin e anëtarëve të këtij institucioni. Kandidatura e Lleshit u përzgjedh nga mazhoranca mes kandidatëve tjetër përballë saj, Marsida Xhaferllarit.



Lefterie Lleshi

Votimi

Pas procesit të votimit në mënyrë të fshehtë, u arrit që me 72 vota pro, të deputetëve të Partisë Demokratike si dhe votën e Vangjel Dules nga grupi opozitar, në krye të institucionit që do të administrojë zgjedhjet e ardhshme u zgjodh të jetë pikërisht Lefterie Lleshi

shirë kreun e institucionit, është një hap i parë i rëndësishëm drejt zbatimit të Kodit të ri Zgjedhor", tha ai. Ai bëri apel që gjithë aktorët politikë të punojnë së bashku dhe të dëshmojnë vullnetin e kërkuar politik për të zbatuar më tej Kodin e ri Zgjedhor, plotësisht dhe në frymë të mirë.

OSBE PËRSHDNËT KQZ-ËN E RE

Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Eugen Eollfarth,

mirëpriti zgjedhjen e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, nga ana e Kuvendit. "Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, përf-

Konsensusi



Zgjidhen 6 anëtarët e KQZ

Kuvendi ka miratuar seancën e djeshme me konsensusin e opozitës dhe mazhorancës përbërjen e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të propozuar nga partitë politike. PD ka rimandatur dy anëtarët e KQZ, ndërsa PS dhe PBDNJ kanë zgjedhur anëtarë të rinj. Po ashtu dhe LSI do të përfaqësohet për herë të parë me një anëtar.
PD: Hysen Osmanaj
 Vera Shtjefni
PS: Albana Shtylla
 Denar Biba
LSI: Ilirjan Muho
PBDNJ: Jani Jani

Berisha:



"Ristani do jetë përkrah meje"

Kryeministri Sali Berisha e ka vlerësuar ish-kryetarin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Arben Ristani, për punën e bërë. Ai paralajmëroi dje se Ristani do të jetë përkrah tij në betejën të rëndësishme kundër opozitës, por nuk tha se çfarë sektori do të bënte pjesë Ristani pas mbarimit të postit si kryetar i KQZ. "Dua të shpreh falenderim të veçantë për Arben Ristanin, i cili përballoi vështirësitë e jashtëzakonshme të adresura ndaj tij. Për mua është nder dhe kënaqësi e veçantë të vazhdoj bashkëpunimin me të. Ai po largohet vetëm pse ju prishët konsensusin. Por ju mos u bëni merak se në krahun tim do ta keni në betejat e ardhshme", tha Berisha.

KUSH ËSHTË LEFTERIE LLESHI

Lefteri Lleshi, tashmë udhëheqësja e KQZ për 5 vitet e ardhshme, përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë ndërsa aktualisht mban edhe postin e anëtarës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe në Kuvendin e Shqipërisë, Drejtore në Shërbimin Juridik. Më herët Lefteri Lleshi gjatë viteve 1992-2000 ka punuar si juriste në drejtorinë qëndrore të Shërbimit Informativ Kombëtar, ndërsa që prej vitit 2000 deri në vitin 2006 në agjencinë Kombëtare të Privatizimit, si përgjegjëse e Sektorit Juridik. Lleshi ka marrë pjesë në një sërë kursesh dhe trajnimesh profesionale ndërsa zotëron dy gjuhë të huaja anglisht dhe italisht.



NJOFTIM

Televizioni "A1Report" kërkon korrespondentë dhe kameramanë për të përforcuar rrjetin e gazetarëve në të gjitha qytetet e vendit. Kudo që ti jeton, jashtë Tiranë dhe veçanërisht në qytetet:

- DURRES
- LEZHE
- SHKODER
- LAÇ
- VLORE
- GJIROKASTER
- KUKES
- POGRADEC

Dëshiron të punosh si gazetar?

na shkruaj në adresën:
staf.a1report@hotmail.com



Forumi

Lajmi

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, në takimin e djeshëm me ambasadorin e BE në Shqipëri për dhënien e statusit të vendit kandidat dy ditë më parë kanë kërkuar të dinë se përse udha me kushte, qëndrimin për grevën, "Gërdecin" financimin e OJF dhe romët.

TIRANE

JAKIN MARENA

Një ditë pasi publikoi dhe ndau me gazetarët përmbajtjen e raport-progresit për Shqipërinë, kreu i prezencës së BE në Shqipëri, Ettore Sequi, e ka ndarë këtë raport dhe me shoqërinë civile. Por përfaqësuesit e KSHH, të MJAFT, Respublica dhe të romëve, kanë qënë konkretë, teksa e kanë vënë në pozitë të vështirë ambasadorin Sequi në lidhje me grevën e urisë, aksesit

Statusi në BE shoqëria civile, debat me Sequi

Problemet: Greva, "Gërdec", Parlamenti e romët

në ligj për 3 përqindshin e pagesës për gjyqet për shtresat e varfëra, reformën parlamentare dhe publikimin e rezultateve të censurit, dhe për romët.

Vjollca Meçe, KSHH: Kur në të kemi marrë statusin, cili do jetë momenti kur monitorimi i BE do të vlerësojmë impaktin në jetën e qytetarit përmes dhe zbatimit të ligjeve ligjeve?

Sequi: Integrimi impaktin do ta japë shkallë pas shkalle. **Në raport thuhet që mbështetja financiare për Shoqërinë civile nuk është nivelin e duhur. Duke qënë se delegacioni i BE është donatori kryesor, do të vijojë këtë mbështetje për të?**



Ettore Sequi

Kemi qënë dhe do vazhdojmë të jemi donatori kryesor për shoqërinë civile shqiptare. Do ketë dy thirrje për të parqitur projekte për financimin por në perspektivë Bashkimi Evropian po tenton që OJF-të t'i transformojë në subjekte që

do të vetëfinancohen.

Dorian Matia, Respublica: Duke vlerësuar shumë atë çka raportit përmban për rolin e Shoqërisë Civile por dhe vlerësimet tuaja për të, do të doja të merrja një shpjegim për fiksimin në ligje të 3 përqindshit për shtresat e varfëra që nuk kanë para për të hapur një gjyq. Bëjmë fjalë këtu për raste të tilla, ku duhen dhe afër 60 milionë lekë për hapjen e një gjyqi, si në rastin e "Gërdecit" ku një familje ka pasur shumë të vdekur, ose shumë të plagosur. Apo rastin e shqiptarëve në Greqi, me mbi 400 mijë

emigrantë. Nuk është e përcaktuar në ligj, ndërsa ata s'kanë të paguajnë?

Sequi: Kemi dëshatur në këtë pikë, e pranojmë, sepse nuk kemi siguruar aksesin e duhur në drejtësi për njerëzit të varfër dhe të pamundur në këtë drejtim. Keni probleme dhe të ligjeve që kemi bërë, por dhe me implementimin. Dhe kjo ka lidhje drejtpërdrejtë me reformat në sistemin e drejtësisë. Është problem thelbësor.

Aldo Merkoqi, MJAFT: Parlamenti ka qënë prioriteti numër një për t'u plotësuar dhe ishin adresuar kritika të drejtpërdrejta për të, në mënyrë që të realizoheshin në kuadër të



12 prioritetëve. Duke qënë se Parlamenti s'ka kaluar reformën parlamentare dhe duke qënë se vitin e fundit ka pasur një sërë shkeljesh si, 16 ligje pa kuorum në Komisionet Parlamentare dhe ka pasur 12 falsifikime të procedurave në komisionet parlamentare përsa i përket prezencës, pra duke pasur këto shkelje mbi çfarë një bazuar që i kemi dhënë notën e të plotë-

Analiza

Me vetëflim për Ligjin dhe të drejtën



NGA PREÇ ZOGAJ

vijon nga faja

...askush tjetër në racën tonë dhe si pakush tjetër në lëmshin tokësor. Janë kaq të rrallat tentativat e vetvrasjes me djegie dhe duket e drejtë ajo që thonë psikologët se mendimi mbizotëruar i personit që e ndërmerr këtë veprim nuk është vetvrasja, por revolta, qëndresa, kundërvëprimi. Jan Palach ishte vetëm një djalosh i imët përballë ushtrive të traktatit të Varsavës që kishin pushtuar e shkelur me këmbë pranverën e parë të lirisë në atdheun e tij. Por ai i sfidoi ato dhe fitoi historinë. Lukën tonë të Pukës nuk e morën e nuk mund ta merrnin gazetaret sepse Shqipëria ishte vendi më i mbyllur i planetit. I pagëzuar martir në himne e trupit të vet, ku siç e pat qarë e ëma në varrim, "s'paskam ku më të lidh sahatin", Lukë Ndoue Lleshi është një emër që i ka dalë nga kthetrat harresës por nuk ka marrë ende kujtesa komëbëtare, se cilës vijon t'i thërresë që nga amshimi.

NJË KRIZË E VJETËR KOMUNIKIMI DHE TËHUJËZIMI

Një çerek shekulli më vonë kemi rastin e dytë dhe të tretë të vetëdijegjes në Shqipëri. Janë sërish dy të përnd-

jekur politikë nga diktatura, Gjergji Ndrea dhe Lirak Bejko, por në kushte të tjera, kur vendi ka më shumë se dy dekada që ka vendosur pluripartitizmin. Gjergji dhe Liraku ndërmoren një veprim ekstrem revolte kundër një qeverie të cilën e kanë konsideruar të tyrën për shumë kohë dhe kundër një kryeministri të cilin Gjergji ka thënë se e kishte mbështetur e dashur si Jezu Krishtin. Në këtë kuptim akti i tyre ka ngarkesën e rëndë të zhgënjimit, gjë që e bën akoma më dramatik e më të hidhur. Jemi përpara valës më të re të përballjes ciklike me qeverinë dhe kryeministrin Sali Berisha të kësaj shtrese që kësaj radhe me sa shihet përfaqësohet me gjeneratën më të re të ish të përndjekurve, domethënë me disa që ishin më të rinj se shumë bashkë-vuajtës të tjerë kur fituan lirinë.

Nuk mund ta dimë me saktësi cilën hakmarrje projektuan Gjergji dhe Liraku me flakët që ndezen në trupat e tyre përkatësisht në ditën e shtatëmbëdhjetë dhe në ditën e njetzetë të gërvës së urisë.

Por akti i tyre i jashtëzakonshëm nxjerr në pah një krizë të vjetër të komunikimit të PD-së, më saktë të kryetarit të saj, me shtresën e të përndjekurve politikë të diktaturës, si shtresa më e afërt me ketë parti dhe si pjesë integrale e saj për shumë vite. Me vizionin e tyre të lirisë, të përndjekurit nuk e kanë patur ndonjëherë problem që partinë e parë legale antikomuniste në Shqipëri nuk e themeluan dot vetë. Ashtu ishin rrethanat e kohës. Ata i kanë mbështetur qysh prej fillimit me gjithë shpirt studentët e dhjetorit 1990, pedagogët e tyre dhe intelektualët e tjerë, që u bënë drejtues të lartë të PD-

së edhe pse disa kishin mbajtur teserën e Partisë së Punës. Por nga ana tjetër, Berisha i ka patur gjithnjë problem qëndrimet e lira që kanë mbajtur në periudha të caktuara individët dhe grupet që vinin nga kjo shtresë. Nuk u ka njohur elementaren Berisha këtyre njerëzve: statusin e njerëzve të lirë e të fortë, këtë lloj titulli pa dekrete që nuk jepet as me medalje, as me shpërblime por vetëm në formën e lartë të repektit për mendimin e lirë. Në mos atyre që kanë sakrifikuar për të, kujt tjetër mund t'i respektohet më shumë liria e mendimit? Në të gjithë llojet e protestave dhe grevave që kanë zhvilluar të përndjekurit politikë të diktaturës që nga viti 1994 e këndej, Berisha dhe gjithë pushtetet e tjera që kanë derivuar prej tij kanë folur me ta me gjuhën e dhunës fizike e verbale, me gjuhën e zhanazhit, përballjes dhe shpifjeve, me gjuhën e denigimit, distancës dhe mbylljes së gojës.

Koha ka bërë të veten. Sot nuk ka e nuk mund të ketë më nxjerrje me dhunë të ish të përndjekurve nga greva, si në gusht të vitit 1994, fjala vjen. Kanë evoluar format e reagimit qeveritar. Por një gjë ka mbetur siç ka qënë qysh prej fillimit: Berisha vazhdon të ketë një qasje populiste dhe klienteliste me këtë shtresë, vazhdon t'i shohë si njerëz të manipuluar nga kundërshtari i tij politik të gjithë të përndjekurit që nuk i fërkojnë krahët, që nuk janë dakord me të, që protestojnë kundër tij. Është vërtetë shumë e rëndë që kryeministri i vendit, njeriu që në dhjetorin e vitit 1990 ka vënë gurin e tij të veçantë në themel e shoqërisë së lirë shqiptare, të mos shohë gjekundi, as dhe, as sot, njerëz të lirë në këtë vend, por

vetëm vegla, vetëm të manipuluar nga kundërshtari, vetëm pijanecë, vetëm interesaxhinj e shurmashinj. Të reduktosh botën në dy njerëz, ku njëri prej tyre je ti dhe tjetri vegimi i kundërshtarit tënd, pra prapë ti, kjo është të jetosh plotësisht jashtë realitetit, në një delir të paskajshëm.

Në këtë kontekst, shpërthimet e Gjergji Ndrecës dhe Lirak Bejkos dhe vetë greva e urisë nuk janë të castit, por një dramë e thellë që ka ardhur duke u mbledhur jave pas jave e muaj pas muaji pikësepari si një reagim ndaj një kontrate të deformuar e të prishur nga qeveria. Nëse marrim vetëm aspektin e kompensimit ekonomik dhe meqë jemi të rasti i Gjergji Ndrecës, qeveria në vend që të vinte vetulla nxorri edhe sytë këto ditë kur me demok hapi letrat për t'i treguar popullit (në fakt për t'i mbyllur gojën Gjergjit) se paska marrë ky njeri. Po të llogarisim vlerën reale të letrave me vlerë të para shumë vjetëve dhe tre mijë dollarët që paska marrë marrë nga kësti i parë i bie që ky ish i burgosur të ketë marrë gjatë këtyre 22 vjetëve të shoqërisë së lirë rreth 3500 dollarë maksimumi, një shumë që një pjestar i klientelës qeveritare të kazioneve e hedh në lojë me një dorë në raundin e radhës pa kur dritdhur çerpiku. Kishin nevojë për këtë shifra për të kuptuar më mirë të gjithë, edhe ata që mendojnë se po na hanë të përndjekurit, të vërtetën e kompensimit të tyre. Të përndjekurit, sikurse qytetarët e tjerë në këtë vend kanë parë e po shohim si është thelluar përtej çdo logjike hendeku midis tyre dhe pushtetarëve të pasuruar me korrupsion dhe forma të tjera të paligjshme. Të përndjekurit kanë

pikasur diçka të paqartë, për të mos thënë një mashtrim në manovrat e qeverisë për të fituar kohë në lidhje me kompensimin. Duke e shtruar shqetësimin e tyre me protesta dhe këtë raport e tregojnë deklaratat të Kryeministrin dhe Presidentit të Republikës kur thonë nuk negociojmë sepse grevistët kanë bërë deklaratat politike. Domethënë të përdjekurit politikë në diktaturë e paskan me dëm të flasim politikisht në demokraci! A mund të ketë aburditet më të madh?

Qeveria, në të gjitha rastet dhe ca më shumë sot kur po kontestohet nga grevistë që e kanë votuar, ka detyrimin t'i trajtojë me qetësi dhe realizëm kërkesat e tyre. Nuk e mohan kush se janë bërë disa gjëra të kaluarën. Nuk dyshon kush se të përndjekurit nuk janë egjostë dhe irracionale që të mos shohin në të drejtën e tyre për kompensim nga shteti një nevojë për ruajtjen e ekuibrave sociale dhe ekonomike në vend. Por këtu flitet konkretisht për kompensimin sipas Ligjit në fuqi, për zbatimin e ligjit në fuqi, pse jo, për përsimërimin e ligjit në fuqi. Në fund të fundit për ketë po bëhet greva, për ketë po vetfilljohin Gjergji dhe Liraku me shokë. Për sundimin e Ligjit, për shtetin ligjor. Që e përjashton klientelizmin dhe populizmin. Ja pse kjo nuk është betejë vetëm e një grupi apo e një shtrese.



Vizita

Berisha do të jetë sot në Deçan për të inauguruar një statujë të Isa Buletinit dhe ku do të bëhet "Qytetar Nderi". Ai do të vizitojë dhe varrezat e dëshmoreve të UÇK-së në Glogjan.

Sequi

"Roli i shoqërisë civile është thelbësor për ndryshimin e cdo vendi e në Shqipëri shoqëria civile ka një forcë transformative, është hallka e duhur sa i përket reformave.

Në foto: Ambasadori i BE në Tiranë Sequi me Shoqërinë Civile

për grevën e urisë, dhe nëse ka, cili është ky qëndrim?

Sequi: Përsa përket reagimit të parë nuk ishte me grevën por kishte të bënte me komentimin e dytë nëse statusi ishte dhuratë për 100 vjetorin e pavarësisë apo i merituar. Ndërsa përsa i përket qëndrimit ndaj grevës ne e kemi bërë të qartë në deklaratat tona dhe kur kam qënë te greva dhe kur isha te zoti Ndreca në spital. Për këtë mund tu japim dhe dokumentacionet përkatëse.

Adriatik Hasantari, "Romët": Meqënëse për herë të parë u bë regjistrimi popullsisë dhe bancesave dhe këtu janë përfshirë dhe të dhënat për minoritetet, dhe delegacioni i BE ka qënë donatori kryesor, çfarë mendoni për shifrat për minoritetet si dhe për një fotografim real për romët, pasi duket se nuk jepet asnjë e dhënë?

Sequi: Është problem teknik. Por unë them se është më mirë të jepen rezultatet vonë dhe të sakta se sa shpejt dhe të nxituara. Mund të kemi dhe implikime politike, pasi s'përfundohen dhe këto.

juar. Ka pasur dhe probleme dhe arritje. Ka dialog politik në Kuvend, ka përmirësim të etikës në Kuvend dhe për më tepër ka vullnet dhe dëshirë për të arritur konsensusin mes palëve.

Përsa i përket grevës së urisë jeni në dijeni që në momentin e dhënies së statusit, një grevist i vuri flakën vetes. Duke qënë se Fyle dha një përgjigje jo fort të kuptueshme, dua të t'i, nëse kjo kishte të bënte me qëndrim zyrtar të KE

suarit këtij prioriteti?

Sequi: Është ende një kusht për t'u realizuar deri në Dhjetor. E rëndësishme për ne është që ka pasur miratim ligjesh me 3/5, kthim të opozitës në Kuvend dhe dialogu politik ka vi-

Analisti: Shanse për 3 kushtet në dhjetor

Hoxha: S'ka BE nëse Rama ndal 'trenin në Fier'

"Politika solli statusin me bishta"

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Përfaqësuesi i shoqërisë civile, analisti i njohur Artan Hoxha në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" thotë se plotësimi i tre kushteve për Shqipërinë në dhjetor është i mundshëm, pasi po të kishin dashur palët do t'i kishin miratuar ligjet, dhe s'do merrej një status me bishta. Ai tha se nëse opozita "ndal trenin në Fier" nuk bëhet fjalë për arritjen në Bruksel të Shqipërisë. Për sa i përket kushtit për zgjedhje të lira, ai tha se sa herë humbet qeveria s'ka kontestime, kur humbet opozita ato bëhen.



Artan Hoxha

Statusi në BE

Sequi i jep Ramës progres raportin: 2013-ta, rëndësi

Për shkak të impenjimeve jashtë vendit, kreu i PS Rama mundi të marrë nga ambasadori Sequi progres-raportin e KE ku rekomandohet statusi i kandidatit mëngjesin e djeshëm. Ai shpreh krenar për kontributin e PS në këtë proces, duke nënvizuar se nga PS s'do të mungojë bashkëpunimi për plotësimin e 3 kushteve të vëna nga KE. Por më parë duhet të zgjidhet çështja e qarkut të Fierit. Kushti i zgjedhjeve të lira më 2013 për çeljen e negociatave, nga Rama u cilësua i drejtë. Ndërsa ambasadori i BE kërkoi që palët politike të arrinin dialogun për të plotësuar kushtet deri në dhjetor.

mentë të tjerë ndihmës. Mendoni se politika shqiptare do ia dalë që të realizojë një proces zgjedhor të pakontestueshëm?

Në të gjitha zgjedhjet nga viti 1991-2011, sa herë që qeveria e radhës ka humbur zgjedhjet e radhës rezultati është pranuar dhe sa herë që opozita e radhës ka humbur zgjedhjet rezultati është kontestuar me pretendimet për manipulime. Kjo është e vetmja e përbashkët e sjelljes së paleve ndaj rezultati. Nëse humbet mazhoranca aktuale rezultati do pranohet dhe zgjedhjet do të quhen automatikisht të mira por nëse humbet opozita aktuale asaj do t'i takojë për herë të parë të silllet ndryshe nga e kaluara. A do ta bej?

Dhe e fundit, pse Shqipëria ia ka dalë gjithnjë të jetë e fundit në rajon për gjithëka?

Për të njëjtat arsye për të cilat ka qënë e fundit dhe 100 vite më parë, e për të njëjtat arsye që dhe komunizmin e kishim më të keq se të kujdo tjetër në rajon e më gjërë se kaq.

Komisioni Evropian rekomandoi dje për Këshillin e Ministrave të BE dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, një status me kushte. Mendoni se mori fund kalvari i procesit të nisjes së udhës së integritimit për Shqipërinë?

E si paska marrë fund? Nuk kemi bërë as 3/5 e rrugës.

KE vendosi për dhënien e statusit në dhjetor tre kushte, të cilat janë cilësuar dhe nga ambasadorët e fuqishëm në Tiranë por dhe nga politika të realizueshme, që janë: reforma parlamentare, miratimi i ligjit për Gjykatën e Lartë dhe ligji për Shërbimin Civil. Mendoni se politika do të arrijë që të përmbushë dhe këto tre kushte për të marrë përfundimisht statusin në dhjetor?

Tre aktet në fjalë janë aq shumë gati sa mund të ishin miratuar dhe një javë më parë në Kuvend e rekomandimi këtë të mërkuar për dhënien e statusit do kishte qënë pa bishta. Edi Rama, në konferencën për shtyp me ambasadorin Sequi, fill pas dorëzimit të raportit, rikujtoi çështjen e Këshillit të Qarkut Fier. Nëse opozita "ndal trenin në Fier" ai s'mund të arrijë në Bruksel.

Situata politike po nxeht shumë dhe për shkak të zhvillimeve në krahun e të përndjekurve politikë. Mund të ndikojë kjo dhe nëse nuk arrihet statusi në dhjetor, çdo të thotë për politikën shqiptare dhe Shqipërinë?

Larg qoftë mosmarrjes së statusit në dhjetor. E nëse nuk e marrim për shkaqe shqiptare, pra për moskryerjen e një, dy apo të tre akteve të sipërcituara, është një dështim i madh i yni e me pasojë të rënda afatmesme. Nëse i kryejmë tre detytrat dhe ndonjë shtet anëtar i BE do luajë kapriciozin në dhjetor, turp për të.

Për hapjen e negociatave në vitin e ardhshëm, nëse vendimi i kryeministrave të vendeve të BE është pozitiv në dhjetor, është vendosur si kusht zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, lufta kundër krimit dhe korrupsionit dhe disa ele-

WWW.PRIMO.AL

RIKTHEHET PRIMO

DYFISHONI SHPEJTËSINË ME PRIMO

Duke filluar nga 1300 Lekë për 1Mbps, pa kufizim trafik. Instalim dhe modem falas.

Dhurata speciale këtë vjeshtë, vjen nga Primo!

PRIMO do të dyfishojë shpejtësinë, vetëm për ju!
Ju jeni prioriteti ynë, ndaj përpiqemi të ofrojmë më të mirën.

1 Mbps	1300 Lekë në muaj
2 Mbps	2000 Lekë në muaj
4 Mbps	3400 Lekë në muaj

Të gjitha çmimet janë me TVSH.

Kjo ofertë është e vlefshme deri më 31 dhjetor.

04 44 00 123

primo

Telecom Albania Group



Intervista

INTEGRIMI Eurodeputetja gjermane kërkon nga politika shqiptare që dhe pas marrjes së statusit të vendit kandidat të dialogojë.

Pack: 2013, kusht për negociatat

Eurodeputetja tha se marrja e statusit të vendit kandidat s'do të thotë se menjëherë do hapen negociatat. Zgjedhjet e 2013, kushti. Pack thotë se grevistët e urisë duhet të trajtohen me respekt

■ ■ ■ TIRANE

Lajmi

Eurodeputetja Doris Pack është shprehur se politika shqiptare nëse ka vullnetin e duhur ia del që të realizojë tre kushtet e vëna për një dhjetor të këtij viti. Ajo tha se nuk ka hapje të negociatave me BE, pa realizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme më 2013.



Doris Pack

ngon pjekuria politike.

Dhe për sa i përket KE-së a shihni atje ende pengesa?

Po, pa e përmendur fola për të. Natyrisht, Këshilli ka për ta ndjekur propozimin e Komisionit vetëm në qoftë se plotësohet ajo çka tha Komisioni. Dhe në qoftë se mbërrijmë të dhënia e statusit kandidat, në qoftë se Shqipëria i ka përbushur kushtet që sapo përmenda, atëherë do ketë zgjedhje vitin e ardhshëm dhe pastaj do shohim sesi ka ndryshuar apo s'ka

ndryshuar klima politike, dhe vetëm atëherë do ta formojë opinionin Këshilli, nëse ky vend është i pjekur sa duhet për të nisur negociatat. Pra, zgjat ca.

E kisha më shumë fjalën të ajo që ndonjë anëtar të bllokujë duke mos iu referuar pikave të renditura nga BE-ja?

Ne dimë që [vendimi] në Këshill

duhet të jetë njëzëri. Prandaj, sapo e thash, shihet konkretisht te Maqedonia: një vend është prej shumë vitesh kundër. Unë nuk e kam përshtypjen që në rastin e Shqipërisë të ketë vështirësi fqinjësore të veçanta, por as mund të përjashtoj mundësinë që paraqitja e ofruar nga Shqipëria vitet e fundit pikërisht për arsye të mungesës së dialogut politik midis opozitës dhe qeverisë, të bëjë që ndonjë vend të thotë: Le të presim edhe pak. Këtë s'e përjashtoj dot, por mendoj se Komisioni veprimi mirë duke dhënë këtë sinjal.

Si shihet këtu në Perëndim fakti që pikërisht në këtë moment në Shqipëri, ish-të burgosur politikë i vënë flakën vetes?

Natyrisht, ky është edhe sinjal që tregon se jo gjithçka shkon mirë në Shqipëri. Por duhet ditur se sa e vështirë ka qenë rruga e saj. Ajo erdhi, gati brenda natës, nga një vend i qeverisur vërtet në mënyrë tejet komuniste në situatën ku duhej praktikuar demokracia. Dhe shumë prej gabimeve dhe padrejtësive të kryera më parë në kohën

komuniste nuk janë mënjeluar ende plotësisht. Kjo është realiteti e vërtetë, por për këtë arsye s'duhet mbivlerësuar situata aktuale.

Dhe për sa i takon zbardhjes së ngjarjeve të 21 janarit 2001, si gjykoni, a avancim siç duhet puna e gjykatave dhe e prokurorisë?

Qysh atëherë ajo po zvarritet, por unë jam e sigurt që në fund çështja do të zbardhet. Problemi është që situata ishte shumë e acuruar, që shumë muaj pas zgjedhjeve opozita nuk mori pjesë në qeverisje dhe organizonte vazhdimisht protesta.

Në lidhje me zgjedhjet e radhës, a do të jetë ky një test real?

Unë nuk e kam parë asnjëherë që pas zgjedhjeve pala humbëse të pranojë se ka humbur. Herën e fundit ato u bënë sipas një ligji zgjedhor të mbështetur në pajtim të gjerë midis partisë qeveritare e partisë më të madhe opozitare. Këtë gjë ne e përsëritëm shumë, realizimin e një konsensusi të tillë.

JOB ANNOUNCEMENTS



Bankers Petroleum Albania Ltd (Bankers) is a subsidiary of Bankers Petroleum Ltd, a Canadian oil & gas company headquartered in Calgary, Alberta. We are listed on the Toronto stock exchange and also on AIM London. Our web address is www.bankerspetroleum.com

Bankers had its plans for the development of the Patos-Marinza and Kucova oilfields approved by the Government of Albania. We are also pursuing additional oilfield development opportunities in Albania. The Shareholders, Management and Employees of Bankers are extremely excited by the challenging prospects and opportunities which lie ahead. Having already experienced eight successful years and established ourselves as the leading crude oil production company in Albania, Bankers will continue to make significant investment in its oilfields in the years to come, with demanding targets for increases in reserves, production, and sales.

To help us meet our objectives, we are continually looking to add suitably qualified people who can demonstrate qualities including enthusiasm, initiative, team-working, leadership and humility. Bankers offers competitive compensation and benefits and has a culture of rewarding good performance. We are committed to the principle of equal opportunity in employment and promote a fair and non-discriminatory work environment.

We are currently looking for qualified candidates to fill one vacant position for Instrumentation Technician

Key Requirements:

- University Diploma in Electrical/Electronic Engineering
- Preferably experience on instrumentation, electrical and/or electronics background
- Preferably experience in configuring and programming of SCADA systems and PLC's
- Intermediate or Advance level of English language
- Proficient computer skills, knowledgeable in programming and instrumentation
- Excellent verbal and written communication skills
- Ability and willingness to learn and work in a team environment, organized, focused
- Ability to establish priorities, meet deadlines, and concentrate on detailed information
- Driving license

Applications including a C.V. and cover letter, in English, should be sent in a sealed envelope to the Human Resources Department at the following address:

Lagja "Sheq i Madh", Rr."Leonardo Murialdo", Fier, Albania.
Tel: +355 34 2208 45 /6/7/8
Fax: +355 34 220850

or by E-mail to: humanresources@bankerspetroleum.com

The deadline for submitting applications is 26 October 2012. All applications will be considered, and responses sent out as soon as possible.



Institucion i specializuar në gjuhën angleze me përvojë 12 vjeçare suksesi

email. info@london-tirana.com

www.london-tirana.com

• KURSE PER FEMIJE

Nga moshja 5 vjeç vetëm me pedagogë të huaj (anglezë ose amerikanë).

• KURSE PER TE RRRITUR

Mësimdhënie e fokusuar në komunikim nga pedagogë të kualifikuar dhe me experiencë

• CERTIFIKATAT NDERKOMBETARE

Përgatitje për provime si:

- FCE
- CAE
- IELTS
- TOEFL (iBT) + (ITP) **New**
- TOEIC **New**
- SAT **New**

• MESIME INDIVIDUALE

Kurse të përshtatura sipas nevojave të çdo individi.

SHKOLLE/VERORE

Kurse dyjavore në Londër, Angli.

London Language Institute

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pall.114, Tiranë, Shqipëri

Tel. +355 (4) 22 30 180

Tel. +355 (4) 22 42 745

Mob. +355 69 21 42 188





EKONOMI

Kuvendi miraton koncensionin 99-vjeçar për Valiasin

Kuvendi ka miratur dje kontratën për Kadhënie në përdorim, në formën e huapërdorjes, me çmimin 1 euro, të një pjesë të truallit të Ndërmarrjes së Qymyrgurit Valias, me sipërfaqe të përgjithshme afro 9 hektarë, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "The American International School

System - Albania", me administrator ish-deputetin e PD Sokol Bejleri. Kontrata përcakton një çmim simbolik prej vetëm 1 euro, ndërkohë që e drejta e koncensionarit shtrihet në 99 vjet. Sipas projektit, në këtë rajon do të ndërtohet një kampus i arsimit parashkollor, të mesëm dhe të lartë, bazuar në modelin amerikan. Njëpërmjet këtij investimi mendohet të

punësohen 1.000 persona. Parashikohet që kampusi të realizohet në dy faza: në fazën e parë, që është 18 muaj, do të ndërtohen godinat dhe vlera e investimit do të jetë 18 milionë dollarë, kurse në fazën e dytë, 18 muaj të tjerë, në vlerë 40 milionë dollarë, do të përfundojë plotësisht. Në të ardhmen do të ndërtohen edhe shkolla pilot në rrethe.

Zëri i Amerikës interviston avokatin e firmës konsulente Patton Boggs

"Albpetrol, paratë jo problem"

Përfaqësuesi i konsulcencës tregon lidhjet e kompanive në konsorciumin fitues të tenderit, procesin e vlerësimit teknik-financiar, mundësitë e pagesës së 850 milionë eurove

■ ■ ■ TIRANË

Lajmi

Pas shpalljes fitues në tenderin për privatizimin e Albpetrolit të konsorciumit Vetro Energy, përfaqësuesi i kompanisë konsulente Patton Boggs, avokati amerikan David Farber, ka treguar për "Zërin e Amerikës" aspektet teknike dhe financiare që janë vlerësuar në proces



Avokati David Farber

Zëri i Amerikës ka intervistuar dje avokatin David Farber, përfaqësues i kompanisë Patton Boggs. Kjo firmë ka kryer konsulencë për qeverinë shqiptare gjatë shitjes së ARMO-s dhe Albpetrolit. Sa më poshtë, vijon intervista e plotë.

Albpetroli, firma e vetme shtetërore që shfrytëzon fushat e naftës në Shqipëri, është një nga pasuritë më të mëdha publike që po privatizohet. Firma fituese e tenderit, konsorciumi Vetro Energy, ka ofruar 850 milionë euro për blerjen e Albpetrolit. Kjo firmë duhet të depozitohet tani në formë të paqthyesme 20 për qind të vlefës për të filluar negociatat me qeverinë shqiptare. Në këtë proces qeveria shqiptare ka marrë si këshilltar ligjor firmën amerikane Patton Boggs. Gazetari Arben Xhixho, i Zërit të Amerikës, bisedoi me avokatin David Farber, lidhur me procesin e privatizimit të Albpetrolit.

Zoti Farber, faleminderit për këtë intervistë. Albpetroli është një nga pasuritë më të rëndësishme që Shqipëria po privatizon, të paktën për nga vlera monetare. A mund të na sqaroni fillimisht rolin që luajti firma juaj në këtë proces?

Patton Boggs, së bashku me partnerët tanë në Tiranë, studion e njohur ligjore Zaka-Kosta, shërbyen si këshilltarë të ministrisë së Energjetikës për privatizimin e Albpetrolit. Ky angazhim filloi para disa vitesh; na u desh kohë e gjatë të vijmë deri këtu, por sot jam i kënaqur që jemi në këtë fazë të projektit. Pra, ne kemi shërbyer si këshilltarë, së bashku me partnerin tonë lokal Zaka-Kosta.

A ishte firma juaj ajo që bëri vlerësimin e gjithë ofertave, duke i klasifikuar ato? Dhe si e bëtë ju renditjen?

Patton Boggs, në partneritet me firmën Zaka-Kosta, bëri vlerësimin e ofertave. Siç e dini, periudha e paraqitjes së ofertave u hap më 6-7 shtator dhe ne menjëherë filluam vlerësimin e tyre. Ofertat, me një përjashtim të vetëm, kishin paraqitur dokumente të shumta, kishim materiale të bollshme financiare për të vlerësuar. Firmat e interesuara paraqitën planin e biznesit 5-vjeçar, në bëmë vlerësimin e tyre, i vlerësuar ofertat për nga kriteret teknike, në se i plotësonin ato apo jo dhe pastaj vlerësuar çdo ofertë në tërësi. Patëm 6 oferta, bëmë vlerësimin për secilën prej tyre. Kriteret, si pjesë e procesit të tenderimit, ishin bërë të njohura që në fillim, që kur u shpall privatizimi. Që

atëherë u përcaktua se si do të bëhej vlerësimi dhe klasifikimi i çdo elementi të procesit të privatizimit. Bazuar në këtë proces, vlerësuar çdo ofertë dhe raportin përfundimtar ia dërguam ministrisë shqiptare me rekomandimin tonë.

Dy ndër elementët kryesorë vlerësues ishin kriteret teknike, pra përvoja e firmave në shfrytëzimin e fushave të naftës dhe kriteret monetare, sa para do të ofronin ato...

Po, ashtu është.

Le të ndalemi tek secila prej tyre. Me atë që dini ju, kur u krijua firma YPO dhe çfarë përvoja teknike sjell ajo, që e kualifikon mbi të tjerat?

Kriteret u ndanë në dy kategori

Oferta e Vetro mbështetej edhe nga një bankë investuese ndërkombëtare - BNP Paribas, me përvojë në energjetikë

kryesore, në atë financiare, që ishte thjesht shuma që do të ofronin. Kriteri financiar do merte një vlerësim deri në 75 pikë ...

Do të ndalemi tek ana financiare më vonë, por le të flasim për aspektet teknike në fillim.

Për anën teknike, pyetja juaj ishte përsë u zgjodh YPO. Ne nuk vlerësuar firmën YPO më vete. Firma YPO është pjesë e një konsorciumi, ku bëjnë pjesë SilkRoad Equity dhe dy partnerët e tjerë, Huddleston Energy dhe Home Creek Energy. Ne e vlerësuar konsorciumin në tërësi dhe, bazuar në kualifikimet e konsorciumit, ishim në gjendje të vlerësonim përvojën, aftësitë teknike, si dhe aftësinë për të realizuar planin 5-vjeçar

të biznesit. Në rastin e firmës Vetro, ajo që ishte e veçantë për të, është se oferta e tyre mbështetej edhe nga një bankë investuese ndërkombëtare - BNP Paribas, me përvojë të gjatë në sektorin e energjetikës.

Cili është roli i kësaj banke? A e këshilloi ajo firmën YPO?

Nuk e di në se ajo këshilloi firmën YPO ose jo, por ajo këshilloi konsorciumin Vetro, pra këtu kemi një kombinim të dy elementëve kryesorë të konsorciumit, SilkRoad YPO dhe Huddleston e Home Creek nga njera anë dhe bankën investuese, që është këshilltare e tyre, nga ana tjetër, që ne na u paraqiti si pjesë e ofertës. Ne analizuam këtë përvojë dhe i kërkua, jo vetëm Vetro-s, por të gjitha firmave, që paraqitën oferta, të na japin hollësi të shumta nga përvoja e së kaluarës, në shfrytëzimin e naftës dhe gazit, si dhe në tregtimin e tyre. Të gjitha firmat e interesuara, jo vetëm Vetro, na paraqitën projekte konkrete që kanë kryer, fusha naftë që kanë shfrytëzuar. E morëm këtë informacion nga të gjitha firmat. Pastaj bëmë punën tonë për të kontrolluar, me sa mundëm, informacionin. Verifikuam një pjesë të mirë të tij dhe kjo na çoi në klasifikimin e firmave nga ana teknike. Dua të theksoj se vlerësimi teknik nuk kishte të bënte thjesht me aftësinë për të drejtuar një biznes të caktuar, apo për planin 5-vjeçar të biznesit, por edhe me çështje të tjera, si për shembull për ato mjedimore, shëndetësore, të sigurimit teknik, të punësimit e të tjera.

Edhe një pyetje e fundit për aspektet teknike. A është e saktë të thuhet se dy firmat: Huddleston Energy dhe Home Creek Energy, janë dy firmat kryesore të konsorciumit për shfrytëzimin e fushave të naftës në Shqipëri?

Po, ato janë qendra e ekspertizës teknike. Të dyja ato kanë përvojë të

gjatë dhe secila prej tyre këshilloi konsorciumin Vetro

Cili është roli i firmës SilkRoad Equity?

Ajo është partnere me firmën YPO dhe së bashku janë pronare të konsorciumit Vetro.

SilkRoad nuk është e specializuar në energjetikë; a do të jetë roli i saj më shumë në aspektet financiare të konsorciumit?

Nuk më kujtohen hollësitë e përvojës së tyre në sektorin energjetik, për momentin nuk më kujtohen, por, pa dyshim, ata do të ofrojnë një pjesë të mbështetjes financiare.

Ju thatë se aspektet financiare morën deri në 75 pikë. Një ndër kriteret kryesore ishte përzgjedhja e atij që paguante më shumë. Dhe oferta më e lartë ishte rreth 1.1 miliardë dollarë ose 850 milionë euro. Dhe ata duhet t'ia paguajnë këtë në 'cash' qeverisë shqiptare në mbarim të negociatave. A i kanë ata këto para?

Çdo gjë që kemi parë deri tani na jep të kuptojmë se ky nuk do të jetë problem. Por çështja këtu është se si kanë ndërmend ata ta financojnë këtë marrëveshje, pra nëse i kanë paratë në dorë, apo do t'i marrin hua. Kjo varet krejtësisht prej tyre.

Nga ajo që dini ju, a i kanë ata paratë në banka dhe do t'ia

Fjala tani është 170 milionë euro, pra 20 për qind, që do të ofrohen nga një bankë si garanci e pakthyesme

transferojnë qeverisë shqiptare?

Nuk mund të hyj në hollësi për mundësitë financiare. Unë e kam studiuar gjendjen e tyre financiare, por nuk dua të hyj aty.

Apo do t'i sigurojnë me hua? Sepse këtu ka dy zgjidhje: ose i kanë paratë, ose do t'i sigurojnë diku. Pra, nga do të vijnë 850 milionë eurot?

Si konsulent i ministrisë, nuk dua të shpreh hamendje se çfarë synimesh ka konsorciumi. Nuk e di, sepse është punë e tyre se si do të vendosin, se si do ta financojnë marrëveshjen. Pra, nëse do t'i marrin paratë borxh, do t'i gjejnë paratë në ndonjë mënyrë tjetër, apo do t'i marrin nga llogaria e tyre

bankare. Kjo do të varet nga konsorciumi dhe nuk është çështje e ministrisë.

Po ju, si konsulent i ministrisë, duhet të jeni në gjendje të thoni se ata janë të aftë t'i gjejnë paratë, bazuar në atë që ju kemi parë, apo jo?

Mos harroni se procesi funksionon kështu: për t'u kualifikuar për të bërë një ofertë, jo vetëm për Vetron, por edhe për të tjerët, duhet të depozitosh një garancë në para. Qëllimi i këtyre parave është pikërisht ky, që të mund të kemi firma serioze në tryezë, pra jo firma që thjesht thonë se janë në gjendje të paguajnë e që në fakt nuk janë. Me shpalljen e konsorciumit si fitues, që u bë javën e kaluar, kërkesa për këtë garanci dyfishohet dhe bëhet 20 për qind. Këtu flitet për shumë para...

Pra, rreth 200 milionë dollarë, që duhet të depozitohen në një bankë...

Fjala tani është 170 milionë euro, pra 20 për qind, që do të ofrohen nga një bankë si garanci e pakthyesme, që në mund t'i kërkojmë në çdo kohë për të mbështetur realizimin e procesit. Ne besojmë se kjo do të ndodhë shpejt, përndryshe procesi nuk do të shkojë përpara. Më lejoni të shtoj se këtu flitet për një sasi shumë të madhe parash, që dikush i depoziton si garanci e pakthyesme dhe kështu duhet të funksionojë procesi.

A është kjo e njëjta bankë ku është depozituar edhe 10-përqindësi i parë, The American Charter Bank?

Ne parashikojmë që garancia prej 20 për qind do të jetë nga një bankë tjetër.

Pra, nëse negociatat nuk realizohen, konsorciumi humbet 170 milionë euro. Por si mund t'i humbasë ai kur nuk i ka këto para?

Këtu është edhe i gjithë qëllimi pse banka vendos një garanci të pakthyesme. Pjesë e procesit është garantimi që hollësitë e ofertave të mbahen konfidenciale dhe ne e respektojmë këtë. Ajo që ne dimë është se kjo duhet të jetë një garanci e parevolueshme nga një bankë e madhe dhe këtë presim.

Sa pritet të zgjasin negociatat?

Ne ende nuk i kemi datat e sakta, por sigurisht dëshirojmë që ato të fillojnë menjëherë. Varet se kur do ta njoftojë këtë konsorciumi dhe, me ta njoftuar, negociatat do të fillojnë.



Brukseli

RAPORTI "Numri i HEC-eve mbetet i kufizuar për shkak të boshllëqeve ligjore"

KE, "notë" negative për energjinë

Ndryshe nga deklaratimet e kryeministrit Berisha se Shqipëria po kthehet në një "superfuqi energjetike", progres-raporti vlerëson se në fushën e energjisë nuk ka gati aspak ndryshime

Lajmi

Progres raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë e vlerëson gati si dështim punën e bërë në sektorin e energjisë gjatë një viti, ndryshe nga deklaratat qeveritare për qindra licenca HEC-esh dhe ecje të vendit drejt një "superfuqie energjetike"

TIRANE

GENC KONDI

Shqipëria ka bërë pak ose aspak progres gjatë një viti në sektorin energjetik. Ky është konkluzioni, që përfshihet në progres-raportin e Komisionit Evropian, i cili analizon me hollësi të gjitha aspektet e punës që duhej të ishte bërë nga institucionet dhe që në fakt nuk është bërë. Sipas raportit, ka pasur pak progres në sigurimin e furni-

zimit me energji. Shqipëria ka përmirësuar kapacitetin e interkonieksionit përmes inaugurimit të një nënstacioni të ri në Tiranë, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të plotësuar lidhjet e interkonieksionit me shtetet fqinjë. Kjo është një kritikë indirekte për bllokimin e ndërtimit të linjës me Kosovën. Sipas raportit, vendi mbetet ende tepër i varur nga kushtet hidrologjike. Qeveria ka vazhduar që të japë leje ndërtimi për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, por



numri i operatorëve mbetet i kufizuar për shkak të problemeve legislative që lidhen me zbatimin e kontratave. Nga ana tjetër, sipas Brukselit, nuk është bërë pro-

gres në përshtatjen e Ligjit të Energjisë me kuadrin ligjor evropian. Kuadri ligjor i Shqipërisë në mënyrë domethënëse nuk plotëson detyrimet e Energjisë së Komunitetit Evropian, thuhet shprehimisht në këtë dokument. Shqipëria nuk ka filluar ende të përshtatë legjislacionin me paketën e tretë të energjisë së brendshme të BE-së.

Theksohet se humbjet në shpërndarje dhe në rrjet janë rritur dhe pagesa e faturave është përkeqësuar më tej. Parvërsisht disa përmirësimeve në prodhimin e energjisë gjatë gjysmës së parë të 2012, ka vështirësi financiare për KESH, që ka qenë i detyruar të kërkojë subvencione dhe hua të garantuara nga shteti. Një konflikt midis KESH dhe CEZ mbi borxhet mbetet e pazgjidhur dhe mund të rrezikojë stabilitetin e sektorit, thekson raporti.

KRITIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN LIDHUR ME SEKTORIN ENERGETIK NË SHQIPËRI

- Shqipëria ka bërë pak ose aspak progres gjatë një viti në sektorin energjetik
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të plotësuar lidhjet e interkonieksionit me shtetet fqinjë
- Vendi mbetet ende tepër i varur nga kushtet hidrologjike
- Ka pak progres në tregun e brendshëm të energjisë
- Numri i operatorëve mbetet i kufizuar për shkak të problemeve legislative që lidhen me zbatimin e kontratave
- Kuadri ligjor i Shqipërisë në mënyrë domethënëse nuk plotëson detyrimet e Energjisë së Komunitetit Evropian
- Shqipëria nuk ka filluar ende të përshtatë legjislacionin me paketën e tretë të energjisë së brendshme të BE-se
- Humbjet në shpërndarje dhe në rrjet janë rritur dhe pagesa e faturave është përkeqësuar më tej
- Një konflikt midis KESH dhe kompanisë së shpërndarjes CEZ mbi borxhet mbetet e pazgjidhur dhe mund të rrezikojë stabilitetin e sektorit
- Monitorimi dhe zbatimi i pushtetit nga ERE mbetet i dobët

DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48

Do na ndiqni në
gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 51

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

ABCOM
KONKURSIONI DITËSHORË SHQIPËRIK
KANALI 158

PIXEL

Realiteti që nuk e keni
shikuar kurrë më parë!

Çdo ditë në

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit



Vikena Kamenica: "Rikthimi im tek xhazi!"

Kengetarja rikthehet me pasionin e saj të vjetër dhe një repertor solid



Një fundjavë midis dy dashurive!



Dashuria harrohet apo zgjat për jetë? Nëse nuk ia keni bërë kohët e fundit këtë pyetje vetes, këtë fundjavë e keni një mundësi ridimensionimi mes këtyre dy vështrimeve mbi dashurinë. Do të gjendeni midis ashtu në oborrin që ndan dy teatrot kombëtarë të Tiranës, atë Kombëtar dhe atë të Komedisë. Në të dyja skenat ia vlen të kaloni fund-

javën tuaj artistike, duke e vënë veten në mes të një argumenti që ia vlen të zhvillohet me shoqëri sidomos gjatë kohës së lirë. Të shtunën dhe të dielën, në Teatrin Kombëtar mund të shikoni sesi dramaturgu dhe regjisori Mihal Luarasi trajton dashurinë e përjetshme ndërsa në atë që dikur ishte salla...

Fundjava

Suplementi i së premtes te SHQIPTARJA.com



NASHO JORGAQI RREFEN LIDHJEN SHPIRTERORE ME DYRROTAKUN: TA PERDORIN TE RINJTE

"JETA IME MBI NJE BIÇIKLETE"

Gati gjashtë dekada me "mikun" besnik, nga rinia deri në ditët e sotme. Pse duhet rikthyer përdorimi i biçikletës

■ ■ ■ TIRANË

ROVENA RROZHANI

Eka nisur kur ishte student. Me një markë italiane. Pas gati gjashtë dekadash mund të jenë bërë 20 të tilla. Profesor Nasho Jorgaqi ka se çfarë të tregojë për "mikun" e tij besnik, biçikletën, e cila ka qenë dëshmitare e ciklit jetësor të tij prej rinisë së hershme deri sot, kur ai me trishtim thotë se po bëhet gati të heqë dorë, sepse mosha bën të vetën. Por ka qenë një jetë e bukur, në lëvizje, me emocione, trishtime prej humbjeve, por edhe kënaqësive të veçanta që vetëm një mjet i tillë vital mund të të dhurojë. Një kënaqësi që profesori pranon ta ndajë me lexuesit e "Shqiptarja.com", duke bërë apel për rikthimin tek mjeti me dy rrota që të bën të jesh shoqëror, në lëvizje dhe i gjallë.

Ç'është bicikleta për ju?
Bicikleta për mua është "miku"

im besnik. Kur them kështu kam parasysh që me këtë mik, kam një njohje prej afro 50-60 vjetësh. Që kur isha student me mundësitë e atëhershme, kisha një biçikletë të vjetër dhe me të fillova. Pastaj me kohë, nga një dekadë në tjetrën kur dola në punë, u rrit edhe mirëqenia ime dhe bleva një biçikletë të re. Kam përdorur dhe ndërruar të paktën 20 biçikleta, deri më tani.

Janë shumë biçikleta për këtë kohë?

Varet, por pjesën më të madhe të tyre, m'i kanë vjedhur. Një pjesë e tyre pasi janë konsumuar, edhe i kam falur. Fakti është që vetë biçikleta si mjet më ka shërbyer dhe më shërben, në kuptimin që është një mjet i thjeshtë, një mjet që të bën të pavarur, një mjet i bindur. Unë për shembull kam pasur raste të tilla që kur ma kanë vjedhur apo më ka humbur biçikleta, e kam përjetuar emocionalisht sepse më dukej sikur kisha një gjë të shtrenjtë dhe të afërt. Deri këtu arrin lidhja fizike... ► Vizion në faqen 14-15



Në foto: Studiuasi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqi pas promovimit të librit të tij të fundit në Akademinë e Shkencave

Luga e Argjendtë

NGA DHURATA THANASI



Ometë me kërpudha dhe fritatë me kungulleshka

Kur mendojmë tryezën e Ngrënies shumë prej nesh mund të sjellin në mend pjata të larmshme dhe të shumta, por ia vlen që mendimet dhe fantazitë të mos I kushtohen vetëm vaktit kryesor të ditës që është dreka. Gatime pak më të lehta dhe ndoshta pak më shpejta... ► Faqe 18



Liam Neeson në ndjekje të shqiptarëve

Vjen në shqip "E bardhë si qumësht"



Tendencë 2012

GATI GJASHTË dekada me "mikun" besnik, nga rinia deri në ditët e sotme. Lidhja fizike dhe shpirtërore me mjetin me dy rrota

Nasho Jorgaqa: "Jeta ime mbi një biçikletë"

Rrëfimi i profesorit dhe shkrimtarit të njohur

■ ■ ■ TIRANE

ROVENA RROZHANI

vijon nga faqja 13


...dhe "shpirtërore" që kam me biçikletën. Është një mjet që nuk ka shpenzime shumë, që nuk ka pretendime si makina. Nevojat dhe pretendimet e biçikletës janë shumë modeste. Njëherë më ndodhi që më morën një biçikletë të cilën sapo e kisha blerë. Ishte e bukur dhe unë e vuajta këtë dhe sa herë që shikoja biçikleta si ajo do rrija ta shikoja a ishte e imja, ose nxirra mallin e asaj që nuk e kisha më. Edhe me stinët e moshës sime, biçikleta nuk më është ndarë, dhe kjo gjë më ka bërë, të ndihem akoma më i lidhur me të. Kam kaluar ngjarje dhe situata të jetës sime edhe nëpërmjet bicikletës. Kur isha i ri kam kujtime të tjera, kur u bëra me familje, merrja fëmijët me biçikletë, me kalimin e kohës u bëra me nipër e mbesa. Kështu që biçikleta është dëshmitare e ngjarjeve të rëndësishme të gjithë jetës.

Ndërsa vitet kanë kaluar si është raporti juaj me biçikletën?

Unë jam ndier dhe vazhdoj të ndihem komod me gjithë vitet që kam mbi supë dhe prapë ajo është me mua, gjithmonë korrekte, gjithmonë e gatshme...Më shërben në çdo kohë dhe e ndiej si një gjymtyrë të pestë.

Kur isha i ri, kisha parasysh edhe disa kolegë më të vjetër, që nuk i harroj dhe ata ishin të pandarë nga biçikleta. Kam parasysh dy miqtë e mi, shkrimtarë të njohur si Nonda Bulka apo Vedat Kokona që e ngrysën jetën deri në pleqëri hipur mbi biçikletën dhe kishin po atë pasion, kënaqësi, mirënjohje ndaj biçikletës si një mjet që do i shërbente në jetë dhe ajo që është më e rëndësishmja si një mënyrë e përjetimit të lëvizjes. Përveç lëvizjes që njeriu bën në këmbë, bën edhe nëpërmjet saj.

Unë prapë do të preferoja biçikletën në vend të makinës. Ndërsa në makinë punon motori, këtu motori je ti dhe biçikleta, bashkëpunimi midis saj dhe teje, krijon lëvizjen dhe ky është treguesi kryesor i vitalitetit të njeriut. Lëvizja është treguesi i faktit që ti nuk rri në vend, por shkurton distancat, ke një liri të gjerë vështri-



Studiuesi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqa

mi, me një fjalë është një mjet që të gjendet. Në moshën time kam edhe kolegë që vazhdojnë me biçikletë psh profesorët Pandeli


Çina, Edmond Tupja, Enver Hysa apo Besnik Dizdari etj. I shoh që lëvizin dhe kur ndalojmë, shkëmbejmë edhe mendime për biçikle-

tat tona. Ajo që na gëzon ne është fakti që tani janë krijuar disa rrethana që biçikleta po shtrihet edhe në brezat e rinj. Kam parë disa pika që japin biçikleta me qira dhe më bëhet qejfi kur shikoj të rinj që marrin biçikleta dhe dalin shëtitje. Kjo i ndihmon, sepse u ushqen shpirtin e kolektivitetit, afrimit e argëtimit. Dhe nëse jashtë ka kohë që biçikleta është një mjet masiv kjo po vjen edhe tek ne tani.

Por biçikleta në kohët e sotme shihet edhe si një mjet i rrezikshëm. Biçikleta ka edhe rreziqet e veta, por nuk është faj i saj. Faj është i infrastrukturës që kemi, i mbingarkesës së trafikut, i pakujdesisë fatale të shoferëve. Edhe unë kam qenë disa herë i rrezikuar. Për shembull përpara disa muajsh kisha qëndruar dhe prisja të haqes semafori. Unë isha pikërisht në korsinë që është për autobusët, taksitë dhe biçikletat. Kur i gjithë trafiku kishte ndaluar, vjen një kamion pas meje dhe më godet nga pas. U rrëzova, biçikleta u rrudh në një mënyrë të tillë që të dyja rrotat

u shtrembëruan dhe unë u gjenda i shtrirë përtoke. Shoferi që erdhi i tronditur ishte i dehur. Fatmirësisht shpëtova! Rreziqe të tjera kam

Më foto:
Studiuesi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqa pas promovimit të librit të tij të fundit në Akademinë e Shkencave



Fenomeni

Bota kthehet mbi dy rrota

Lajmi më i fundit mbi biçikletat vjen nga Stokholmi. Dhjetëra ciklistë kanë marrë pjesë në "Bike in teed" të veshur anglezë të vjetër dhe me biçikleta antike, pjesë të koleksioneve të tyre. Kështu po vjen koha holland-ezët të mos jenë të vetmit përdorues të mjetit me dy rrota.

Në Torino të Italisë, fansat e biçikletave mbështesin idenë se vajta në këmbë ose me këtë mjet deri në qendër të qytetit nuk është vetëm një mbrojtje individuale që çdo njeri i bën mjedistit por edhe një mundësi për të zhvilluar sa më shumë marrëdhëniet shoqërore mes njerëzve. Epoka e mjetit me dy rrota që filloi të mbetet pas nga përhapja e makinave, duket se po rikthehet. Eu-

ropa ka filluar tashmë, këtë rikthim në kohë edhe për shkak të krizës ekonomike, por ndoshta edhe për shkak të mbingopjes me një jetë sedentare. Tituj gazetash të huaja sjellin një përballje mes dy mjeteve lëvizëse a thua se një garë e fortë ka lindur mes tyre.

Në Shqipërinë e vogël, gjërat lëvizin pak më ngadalë. Pas një ngarendje të qmëndur drejt Benzave për të cilën morëm nam në median e huaj por edhe në sytë e turistëve që na vizitonin, biçikletat po bëhen më të dukshme para syve tanë. Pa një infrastrukturë të mirë, (në fakt vetëm semafori me shenjë e biçikletës të sjell ndër mend se ka rregulla dhe lehtësi edhe për mjetin me dy rrota), pa një kulturë të mirë-filtër por me një shtysë të mirë nga jashtë dhe rezis-



tencë modeste nga brenda, biçikleta po përpiqet të gjejë vendin e saj mes shqiptarëve.

Në tregun më të madh të biçikletave në Pazarin e Ri, aty ku dikur ishin zejtarët, janë të paktën 18 pika shitjesh nga 3-4 të tilla që kanë qenë para 20 viteve. Rënien e lehtë të shitjeve njëri prej tregtarëve më të vjetër, Kemal Pashallari e shpreh pikërisht me numrin

e madh të dyqaneve që tregtojnë biçikleta. Përtej kësaj informacioni që na jepet krijon disi idenë e raportit mes këtij mjeti dhe shqiptarëve. "U them klientëve të mi, se një javë makinë e mbyllur është baraz me një biçikletë" - thotë Pashallari. Ai tregon se më të shumtë janë meshkujt që blejnë biçikleta. Femrat me sa duket ende nuk e kanë gjetur shpirtin e sport-

ivitetit të ky mjet. Në një treg të mbushur me prodhime të reja dhe të vjetra, këto të fundit preferohen për shkak të çmimit të ulët, ndërsa mes markave rreth 70 për qind e tyre janë kineze ndërsa pjesa tjetër italiane apo holandeze. Pozitiv është fakti që biçikletat për fëmijë shiten shumë më tepër se ato për të rritur, çfarë të bën të shpresosh se ndoshta brezat e rinj po fitojnë një dashuri për këtë mjet pa kosto. Pavarësisht nga luhajtjet e tregut, fakti që numri i dyqaneve është shtuar, fakti që pikat e sërvisit janë shtuar dukshëm dhe fakti që pikat e biçikletave me qira, Ecovolis gjenden thuajse në të gjithë qytetin, të siguron që të paktën në Tiranë biçikleta po shndërrohet në një trend. Ndoshta shumë më ngadalë se në Europë, por gjithsesi rrotat kanë filluar të

BIÇIKLETOMANIA pushton Europën. Nga më të vjetrat tek më modernet, për shkak të krizës, ambjentit apo dëshirës për sport, bota po fillon të lëvizë mbi dy rrota.

RIKTHIMI i njerëzve drejt mjedit të thjeshtë lëvizës, biçikletës që nuk kushton aspak sa një makinë ndonëse kërkon këmbët për ta vënë në lëvizje.



Shkodra

"Nese është shkodran, do ta blejë patjetër një biçikletë" thotë një shitës në Pazarin e Ri, duke iu referuar pasionit të madh të shkodranëve për biçikletat. Thuhet se janë mbi 35 mijë biçikleta në Shkodër, madje ka familje që kanë nga 2 të tilla në shtëpi.

mua. Kam tension. Tani që mbusha 82 vjeç e lashë për fare".

Modelet e dikurshme cilat ishin?

Unë e kam nisur me biçikletat e vjetra "Bianchi" që ishin biçikleta shumë të mira italiane. Pastaj me biçikletat ruse, hungareze, kineze. Kishte edhe nga prodhimet tona që i nxirrte uzina "Tirana". Ato ishin "Made in Albania". Por këto nuk ishin aq të fisme. Kështu që përpqesha që edhe biçikletën ta kisha cilësore, sa më funksionale dhe të bukur. Kurse në vitet '90 e këtej kam pasur biçikleta perëndimore sidomos holandeze.

Thuhet se shtëjtja në këmbë dhe në biçikletë zhvillon marrëdhëniet shoqërore. Në fakt Europa po i kthehet biçikletës...

Mua më vjen mirë që shoqëria bashkëkohore, po i kthehet gjithnjë e më shumë po i kthehet biçikletës tani, në kushtet jo vetëm të globalizimit, por edhe të ekologjisë globale. Ndiheh mirë që përdorimi i biçikletës nuk është një gjë e kapërcyer, anakronike, por tregon që ne që ngasim biçikletat edhe në këtë moshë jemi bashkëkohorë. Më vjen mirë gjithashtu që biçikleta po fiton atë popullaritet që ka pasur më parë. Vërtet primare konsiderohen makina dhe motorçikleta, por ja që në këto kohë njerëzit edhe pse kanë këto komoditete i janë kthyer biçikletës. Shkodra është qyteti që ka më shumë biçikleta në republikë, njerëzit i përdorin në masë. Sa herë shkoj atje me duket sikur shkoj në atdheun e biçikletave. Me sa di përdorim të gjerë kanë biçikletata edhe në Kinë, dhe në Hollandë. Një fenomen që po përhapet edhe në Europë e SHBA.

Ju ka mërzhitur ndonjë ditë biçikleta?

Jo, nuk ka arritur puna deri aty, madje kam pasur atë ndjesi që të thashë. Ajo më shërben mua aq shumë dhe kam ndjesinë që duhet t'i shërbej dhe unë asaj. Ndjesia vjen natyrshtë. Kur unë e pastroj biçikletën, i shërbej asaj modestisht, kam një lloj kënaqësie. Ndiheh mirë. Sigurisht që është më e vështirë kur shpohet goma dhe je larg, të duhet të nxitosh je i detyruar dhe ta marrësh përdore ose në duar. Por ia fal. Ajo më ka dhënë kaq kënaqësi, më ka shërbyer aq shumë, ndaj ia shpërblej.

Fëmijët i keni mësuar që t'i japin biçikletës?

Djalit im ka makinë, por ka marrë edhe biçikletë. Nuk është se im bir



Një nga pjesëmarrësit në "Bike in Tweed", në Stokholm, tetor 2012

e ka bërë këtë gjë nga modeli i baibait, por nga ato motive që kanë lindur në kohët e sotme.

Biçikleta është komode, por në dimër bëhet e vështirë...

Ajo që i habit shokët dhe miqtë dhe bëjnë shaka me mua kur më shohin ndërsa bie shi, unë me një dorë mbaj timonin, dhe me dorën tjetër çadrën. Lshite një rrethim shumë e keqe që atëherë quhej pelivan dhe kur më shohin tani, më thonë: "Je bërë si Ali Xhixha në majë telit".

Dikur në rini mblidheshit

Festivali i biçikletave

Në 2000 pësova një aksident me biçikletë, u përplasa me një autobus. Ishite një përvojë shumë e keqe por e shfrytëzova në aspektin pozitiv: doja të bëja dicka për ciklistët". Kështu shprehet Brendt Barbur, 41 vjeç, ideator i Bicycle Film Festival, ngjarja që ka filluar këto ditë në Milano. "Nuk jam një politikant ndaj për ta promovuar biçikletën zgjodha mjedit që dua: artin, filmin, muzikën" tregon ai. Festivali zhvillohet prej dhjetë vitesh, duke bërë xhiron e botës. Të paktën 250 mijë spektaktorë në çdo edicion. Por si zgjidhen filmat? Sipas Barbur, pjesa më e madhe janë prodhime me buxhet tejet të vogël, por me shumë stil. Fitojnë pikë ngjarjet që filmat tregojnë por edhe fotografia. Ky festival mbështet tashmë idensë makina nuk është më



për ekskursione me biçikletë?

Më kujtohet miku im Ismail Kadare kur studionim në fakultet. Ai kishte ardhur nga Gjirokastra ku biçikletat për shkak të terrenit nuk ishin praktike. Kështu, kur erdhi këtu, i përdorte me qejf, bile ndonjëherë lëviznim bashkë me shpejtësi nëpër bulevard që nuk kishte atë ngarkesë që ka sot. Më kujtohen shtëjtjet që bënim nga sheshi "Skënderbej" deri te universiteti. Ai nuk kishte biçikletë, por e merrte me qira.

Si do ta bindnit një të ri që të linte makinën dhe të merrte biçikletën?

E para, biçikleta do ta vinte në lëvizje organizimin e njeriut gjë që nuk e bën as motorçikleta, as makina. E dyta, biçikleta është një mjet pa shpenzime, është një mjet komod, nuk ka nevojë për hapësirë për parkim gjë që për mjetet e tjera ka krijuar plot probleme. Biçikleta është modeste në kjo pikëpamje. Do të këshilloja brezat e rinj që para se të shkojnë tek makinat apo motorçikletat, të shkojnë te biçikletat dhe jam i bindur që nëse ata në fillim do të jenë skeptikë, me kohë do ta kuptojmë që ajo ka shumë të mira. Duhet të kenë durim derisa të mësohen dhe t'i provojnë vlerat.

Besoni se kjo mund të ndodhë në shoqërinë tonë?

Dua të besoj dhe shpresoj. Dhe i bëj thirrje sidomos brezave të rinj që të kthejnë sytë edhe nga biçikleta. Ajo është aq modeste, e gjendshme, pa shumë shpenzime dhe është më e rëndësishmja i kryen thjeshtësisht funksionet bazë të jetës së përditshme. Ju bëni shumë mirë si gazetë që e trajtoni këtë problem. Duhet sensibilizuar opinionin dhe kam bindjen se ashtu siç po ndodh edhe në Europë e gjetkë, do të vijë dita që edhe në Shqipëri të masivizohet përdorimi i biçikletës.

Histori



1791
Konti Mede De Sivrac u paraqit ne oborrin mbretëror me këtë mjet të shpikur prej tij. Dy rrota karroce të bashkuara me një pjesë druri dhe që lëvizte pak a shumë si një monopatinë.



1816
Baroni Karl Von Drais përsori shpikjen duke krijuar një vend për tu ulur. Lëvizja vazhonte të ishte si një monopatinë. Por rrota e përparme ishte e rrotullueshme.



1840
Një fabrikues në Glasgow përsori modelin gjerman duke bërë rrotën e pasme më të madhe. Për herë të parë nuk nevojte që të viheshin këmbët në tokë.



1862
Francezi Ernest Michau montoi për herë të parë pedaled, duke i vënë në rrotën e parë dhe duke krijuar lëvizjen. Në vitin 1865 aai prodhonte 400 mjete të tilla ndërsa pak më vonë 200 mjete në ditë.



1868
Lindi biçikli i parë. Pjesët e drurit filluan të zëvendësoheshin me hekur dhe filluan të përdroeshin kushinetat. Rrota e parë ishte më e madhe se e dyta. Prej këtyri viti modelet e biçikletave u përsosën vazhdimisht me kalimin e kohës.

pasur edhe në raste të tilla që ndër-
sa ti je duke ecur dhe në krahe
makina që kanë qëndruar, dikush
hap papritur derën e makinës. Këto
hapjet e dyerve të makinave pa
kujdes janë shumë të rrezikshme.
Më kanë ndodhur disa herë dhe
përpiqem të jem i kujdesshëm që t'i
shmang. Kam miq që më qortojnë
pse përdor biçikletën në këtë trafik
të rënduar dhe me aksidentet që
ndodhin. Ç'është e vërteta jo për
t'u mburrur, por deri tani unë re-
flekset i kam normale dhe nuk kam

Mbaj mend mikun tim, të moshuar atëherë, Vedat Kokona. Një ditë e takova dhe ishte pa biçikletë. I them: "O Vedat, po ku e ke biçikletën?" "Ah e lashë - më tha

asnjë lloj frike, e njoh shpejtësinë e makinave, i njoh situatat kur rrezikohem, respektoj rregullat, por nuk i respektoj në të tjerët. Kjo më bën mua të mendohem që duhet të bëj më shumë kujdes.

Biçikleta njeh moshë?

Mbaj mend mikun tim, të moshuar atëherë, Vedat Kokona. Një ditë e takova dhe ishte pa biçikletë. I them: "O Vedat, po ku e ke biçikletën?" "Ah e lashë - më tha, - sepse duket edhe kjo ka huqet e veta, por huqet kanë të bëjnë me

Dëshiron të shkosh në kinema?

NJË HISTORI që ta mban frymën pezull dhe që ia ka dalë të pozicionohet në krye të arkëtimeve me 50 milionë dollarë të ardhura nga shitjet e biletave

Aksioni thriller "Taken 2", fillon projeksionet këtë fundjavë në kinema

Liam Neeson ndjek shqiptarët

Oliver Megaton dhe Luc Besson tregojnë historinë e një ish- agjenti të CIA-s

Ndërsa gjendet në Stamboll, ish agjenti i CIA-s, Bryan Mills ndiqet papritur nga ish e shoqja Lenore dhe vajza e tij, Kim. Por qetësia e asaj që konsiderohet si një pushim i bukur familjar tronditet menjëherë: babai i një prej kriminelëve të vrarë katër vite më parë nga Mills, gjatë aksionit që ai realizoi për lirimin e vajzës së tij, të marrë peng, kërkon shpazim. Këtë herë është radha e Lenore që të bjerë në duart e rrëmbyesve dhe më pas edhe radha e agjentit Mills. Ai duhet të mbështetet në ndihmën e Kim për ta shpëtuar dhe për të shmangur një kërcënim të ri. Kështu vajza shihet duke rëndur nga njëra cati në tjetrën, duke transportuar një

SKEDA E FILMIT	
Titulli:	Taken 2
Regjia:	Olivier Megaton
Skenari:	Luc Besson, Robert Mark Kamen
Aktorë:	Liam Neeson, Maggie Grace, Famke Janssen, Rade Serbedzija
Gjinia:	Aksion, Triller
Kohëzgjatja:	91 minuta



tarët e tij.

cantë me bomba që i duhen babait të saj, cili pas një sërë taktikash ia del mbanë të shpëtojë familjen dhe të eliminojë një nga një kundërsht-

Ky është filmi "Taken 2" që sheh për protagonistë aktorët Liam Neeson, Maggie Grace, Famke Janssen dhe Rade Ser-

bedzija. Aksioni thriller është vijimi i filmit të parë "Taken" që doli në kinema në vitin 2008. Filmi që fillon projeksonet në kinema Millenni-

um, ditën e premte, është drejtuar nga regjisori me origjinë franceze Olivier Megaton. Skenari i filmit i cili ka përfshirë në personazhet e historisë së tij edhe shqiptarë, është francezi Luc Besson njëherësh edhe producent i këtij filmi që nga seria e parë në vitin 2008. Filmi ka marrë kritika të përziera ndërsa në fundjavën e tij të parë në kinematë amerikane është pozicionuar në krye të arkëtimeve me 50 milionë dollarë të ardhura nga shitjet e biletave. Një shitje e tillë biletash ishte menduar se do të funksiononte për vetë faktin se filmi i parë ishte jo vetëm i ndjekur, por edhe i konsideruar si filmi që shënoi kthesën e madhe në karrierën e aktorit Liam Neeson

PROGRAMET E KINEMASE

NE FUNDJAVE



Filmat në sallë

"Taken 2"
(Në të gjitha oraret)
"Resident Evil 5"
(Ora 18:00)

Orari dhe Çmimet

Filmi 2D
ora 10:30 – 300 lekë
ora 13:00 – 300 lekë
ora 15:30 – 500 lekë
ora 18:00 – 500 lekë
ora 20:30 – 500 lekë
ora 23:00 – 500 lekë

Filmi 3D
ora 10:30 – 500 lekë
ora 13:00 – 500 lekë
ora 15:30 – 700 lekë
ora 18:00 – 700 lekë
ora 20:30 – 700 lekë
ora 23:00 – 700 lekë

NE FUNDJAVE



Filmat në sallë

"The Campaign"
(Ora 18:00)
"Taken 2"
(Në të gjitha oraret)

Orari dhe Çmimet

ora 13:00 – 500 lekë
Qendra Kristal
ora 18:00 – 500 lekë
Qendra Kristal
ora 12:30 – 500 lekë
AGIMI
ora 17:30 – 500 lekë
AGIMI
ora 20:00 – 500 lekë
AGIMI
ora 22:00 – 500 lekë

Milla Jovovich rikthehet në Zombiland



Një horror që është ngjizur nga videojoirat, një prodhim plot aksion dhe fantashkencë që do të thotë shumë sidomos për fansat e kësaj gjinie projektohet këtë fundjavë në kinema Millennium. Dhe jo vetëm fansat e kësaj gjinie mund të kënaqen duke parë aventurën më të re të "Resident Evil" sërisht në 3D, por edhe ata që admirojnë aktoren Milla Jovovich kanë mundësi të shohin edhe njëherë këtë aktore në rolin e Alice, një superheroine që ka misionin e vështirë për të shpëtuar tokën. Historia nis pak a shumë në atë linjë ku përfundoi filmi i katërt i sagës. Virusi vrasës i korporatës Umbrella vazhdon të shkatërrtojë jetën në Tokë duke i shndërruar njerëz-

SKEDA E FILMIT	
Titulli:	Resident Evil: Retribution 3D
Regjia:	Paul W.S. Anderson
Skenari:	Paul W.S. Anderson
Gjinia:	aksion, aventurë, horror, sekuel

it në legjione zombish të uritur për mish njeriu. Shpresa e fundit e njerëzimit është Alice (Milla Jovovich) e cila zgjohet brenda një strukture të fshehtë të Ombrellës duke kryer hetime të plota, ajo zbulon disa nga

sekretet e së shkuarës së saj misterioze. Pa një strehë të sigurtë, Alice vazhdon të kërkojë përgjegjësit për shpërthimin, një ndjekje që do ta çojë atë nga Tokio në Nju Jork, Uashington dhe në fund në Moskë. Udhëtim që do të kulmojë me një zbulim tronditës që do të detyrojë atë të vërë në pikëpyetje gjithçka që ishte e sigurtë më parë. Nga filmat e mëparshëm të sagës ka një sërë aktorësh që gjenden në këtë prodhim të ri. Natyrisht që listën e kryeson protagonistja, Alice që vjen sërisht me fytyrën dhe shpirtin e Milla Jovovich. Po kështu kthehen në historinë e "Resident Evil" aktorët Sienna Guillory (në rolin e Jill Valentine) dhe Boris Kodjoe (në rolin e Luther West).

Kur thumbon "The Campaign"

Një telefonatë e turpshme për të dashurën e tij, por që përfundon gabimisht në sekretarinë telefonike të një familjeje shumë fanatike, e çon kongresmenin demokrat Cam Brady në dëshpërim të plotë. Fushata elektorale, nga një fitore e sigurtë dalëngadalë shndërrohet në një situatë të paqëndrueshme për kongresmenin falë dy

Në duart e tyre Marty shndërrohet në një lloj makinerie të përsosur lufte zgjedhore

vëllezërve miliarderë Motch (Dan Aykroyd dhe John Lithgow), të cilët vendosin që të

çojnë një tjetër njeri në Uashington. Dhe zgjedhin pikërisht djalin naiv të mikut të tyre të pasur Marty Huggins, i cili punon si drejtor i zyrës së turizmit në Jefferson, ë Karolinës së Veriut. Në duart e tyre Marty shndërrohet në një lloj makinerie të përsosur lufte zgjedhore. Ai arrin ta fusë në telashe rivalin e tij, kongresmenin. Por jo për

shumë kohë...

Kjo është një pjesë e historisë së komedisë "The Campaign" (në shqip "Fushata"). Filmi, i gjatë 85 minuta, është drejtuar nga regjisori Jay Roach, i cili ka drejtuar dy kapitujt e sagës së "Austin Powers". Komedia ka për protagonistë komikët Eil Ferrell e Zach Galifianakis dhe Jason Sudeikis.



Dëshiron të ndjekësh një spektakël?

MES DRAMËS dhe komikes, dy histori dashurie që flasin shqip dhe një komedi shekspiriane

Një fundjavë midis dy dashurive!

Ngjiten në skenë shfaqjet shqiptare

■ ■ ■ TIRANE

Dashuria harrohet apo zgjat përjetë? Nëse nuk ia keni bërë kohët e fundit këtë pyetje vetes, këtë fundjavë e keni një mundësi ridimensionimi mes këtyre dy vështrimeve mbi dashurinë. Do të gjendeni midis ashtu në oborrin që ndan dy teatrot kombëtarë të Tiranës, atë Kombëtar dhe atë të Komedisë. Në të dyja skenat ia vlen të kaloni fundjavën tuaj artistike, duke e vënë veten në mes të një argumenti që ia vlen të zhvillohet me shoqëri sidomos gjatë kohës së lirë. Të shtunën dhe të dielën, në Teatrin Kombëtar mund të shikoni sesi dramaturgu dhe regjisori Mihal Luarasi trajton dashurinë e përjetshme ndërsa në atë që dikur ishte sallat e vogël, apo e re, mund të bëheni pjesë e një ironie që dramaturgu dhe regjisori i ri Erjon Kame shpreh mbi dashurinë. Aktorët ashtu si dhe autorët, janë ndarë në brezin e vjetër dhe në brezin e ri. Po aq edhe këndvështrimet mbi dashurinë, njëra thuhet tragjike dhe tjetra komike...

DASHURIA E PËRJETSHME

Të shikojmë drejt dimensionit dramatik. "Përjetësisht Dashuria" e Mihal Luarasit, ngjitet në skenën e Teatrit Kombëtar ditën e shtunë dhe të diel. Kastri i ngushtë prej dy aktorësh. Pak dhe saktë. Ia vlen të mos humbësh interpretimin e aktore Drita Pelinku, për çdo herë unik, por edhe i partnerit të saj, Vangjel Toçe. Për mes dashurisë hidhet dritë mbi vetminë e brezit të tretë, por pa i humbur lirizmin e një dashurie të gjatë në kohë, që gjithësi është me ulje dhe ngritjet e një marrëdhënie. Dy protagonistët, Zarina dhe i shoqi, Dioni, janë pensionistë mbi të shtatëdhjetat që jetojnë vetëm pas largimit të fëmijëve në emigracion. Përmes problemeve të ekzistencës së përditshme, lajmotivi kryesor është biseda për fëmijët, gjithnjë e më të huaj, gjithnjë e më indiferent për fatin e prindërve që kanë lënë pas. Por ajo që i mundon më shumë bashkëshortët dhe ata nuk e thonë kurrë, është frika se mos tjetri vdes i pari. Ata do të jenë dyfish të vetmuar, pa asnjë shpresë për të jetuar të pasnjë. Askush nuk flet për vdekjen, por secili shpreson në heshtje të vdesë i pari. Ngjarja zhvillohet brenda 24 orëve. Fillon me një ëndërr "parafolëse" që ka parë Zarina gjë që hap

mes tyre plagë të vjetra dhe vuajtje të reja, rikthime në të shkuarën e dashurisë, të xhelozisë, të pasionit të tyre të pasuar ...

Ndërsa dy pleqtë mundohen ta jetojnë jetën e tyre ashtu si mundën, një ngjarje metaforike e trondit paqen e tyre të lodhur: në mbrëmje herët, ata zbulojnë se shtëpia

la vlen të mos humbësh interpretimin e aktore Drita Pelinku, për çdo herë unik, por edhe i partnerit të saj, Vangjel Toçe

e tyre është e rrethuar me mure me tulla, duke krijuar kështu një paradhomë të vdekjes, ku nuk punon telefoni, mungon energjia elektrike. Dështon kërkimi i etshëm për të zbuluar shkakun. Të dorëzuar bashkëshortët bien të flenë për të prituri vdekjen. Por nuk mbaron me kaq. Ia vlen të përjetosh momentet e fundit ku loja aktoriale rritet dhe dhuron emocione të forta.



TË HARROSH DASHURINË

Dimensioni i dashurisë shkon drejt komicitetit me "Harroje Dashurinë" që shfaqet të premtën, të shtunën dhe të dielën në Teatrin Kombëtar të Komedisë. Në skenën e re janë aktorët e rinj, Genci Fuga, Elia Zaharia, Helidon Fino, Lulzim Zeqja, Esmeralda Kame, Arjola Basha por edhe Xhevahir Zeneli. Sjellin pjesën e shkruar dhe të drejtuar nga Erjon Kame. Një vështrim mbi një

shoqëri të mashtrimit, ku shpirtat e pastër janë gjithmonë më të dobët, në një shoqëri ku "të fortit" e bëjnë "pis" ndërgjegjen e pastër të njerëzve të singertë". Historia e pjesës sillet rreth një biznesmeni të ri, i cili zbulon se e shoqja e tij e tradhëton. I tronditur nga kjo ngjarje, ai pëson aksident me makinë. Kur për mendet zbulon se ka humbur kujtesën dhe nuk mban mend asgjë nga pesëmbëdhjetë vitet

e fundit të jetës së tij, përfshi edhe martesën. I dashuri i së shoqes përpiqet t'i marrë gruan, ndërsa ortaku i biznesit, kërkon t'i marrë agjensinë e udhëtimeve që kanë hapur bashkë. E shoqja është në dilemë, të iki, ose jo me të dashurin. Kur në skenë hyn gruaja e dashnorit, për kujtimin, personazhi që ka

Dimensioni i dashurisë shkon drejt komicitetit me "Harroje Dashurinë" që shfaqet në Teatrin Kombëtar i Komedisë

humbur kujtesën, gjithçka bëhet e qartë. Edhe ai do të luajë lojën e vet për të vënë në vend dinjitetin e tij. Ashtu sic mund të kuptohet frymëzimi për një histori të tillë i ka ardhur autorit nga realiteti shqiptar, por Kame pranon influencat nga dramaturgjia botërore. Shfaqje vjen për të dytën fundjavë radhazi në Teatrin Kombëtar të Komedisë, ku duket se ka pasur mjaft interes nga publiku.

Metropoli

Të ëndërrosh në papafingo

Një shtrat dhe tetë persona. Një shtrat dhe shumë ëndrra. Një shtrat dhe shumë dashuri... Është "Ëndrra në papafingo", një komedi me regji të Erion Isait. "Ëndrra në papafingo" është një shfaqje e një stili të veçantë, ku nuk kemi një grup statik personazhesh nga fillimi në fund. Janë 8 aktorë që veshin dhe zhveshin lëkurat të shumë personazheve. Dramaturgjia nuk është një e tërë, me të njëjtët personazhe, me të njëjtën problematikë e me të njëjtën bosh. "Nëse do të tentonim t'i vinim një emër shfaqjes "Ëndrra në papafingo" do të ishte "multi-komedi". Ngjarjet e saj zhvil-

Në këtë komedi përmbledhen "Ëndrrat e një nate vere" nga William Shekspir, dialogje dhe monologje të krijuara enkas për këtë shfaqje

lohen në një papafingo. Ku aty personazhet kanë dhomën e tyre të gjumit, kanë "sallën e tyre të konferencës", kanë vendin ku "i rrefehen vetes" (monolog) por e kanë edhe vendin ku mund të tentojnë që të shfaqin ëndrrat dhe dëshirat e tyre që janë sa të bukura aq edhe të pamun-

dura. Por papafingo edhe tjetërsohet duke u bërë një manastir, apo edhe një skenë "gji-gande" për "artistë të jashtëzakonshëm", shpjegon regjisori Erion Isai. Sipas tij, në këtë komedi përmbledhen "Ëndrrat e një nate vere" nga William Shekspir, dialogje dhe monologje të krijuara enkas për këtë shfaqje, si dhe nga kryevepra botërore "Dekameroni", e Xhovan Bokaços dhe një fragment i dramaturgjit. "Kjo komedi vjen e stilizuar duke mos pasur strukturën dhe zhvillimin e një komedie që kemi dëshirë të shohim, por vjen e ndërthurur, duke kaluar nga një ngjarje, në një tjetër ku gjithmonë personazhet i përflasin ëndrrat. Kjo është "Ëndrra në papafin-



go" që shfaqet këtë fundjavë në Teatrin Metropol. Komedi sjell në skenë aktorët Natasha Sela, Albana Sançolli, Kastriot Rramollari, Ajlin Petrela, Lorenc Kaja, Denis Kurushi, Klesta Shero, Olta Cal. Komedia vjen me regji të Erion Isait me skenografi dhe kostumografi të Klajd Ymerit. Nen drejtimin artistik të Suela Konjart.

JETA ARTISTIKE

13-14 TETOR



Teatri i Metropolit

"Ëndrra në papafingo"

Regjia: Erion Isai
Aktorë: Natasha Sela, Kastriot Rramollari, Albana Sançolli, Ajlin Petrela, Lorenc Kaja, Denis Kurushi, Olta Çali
Ora: 20:00

Sinopsi: Tri çifte që nuk e njohin më njëri-tjetrin" dhe dy personazhe, njëra "rob" i teknologjisë dhe tjetra aspirante për t'u bërë këngëtare.

12-13-14 TETOR



Teatri Kombëtar i Komedisë

"Harroje dashurinë"

Autor: Erion Kame
Regjia: Erion Kame
Aktorë: Genci Fuga, Elia Zaharia, Helidon Fino, Lulzim Zeqja, Esmeralda Kame, Arjola Basha dhe Xhevahir Zeneli
Ora: 19:00.
Cmimi: 300 lekë

Sinopsi: Një biznesmen i ri, zbulon se e shoqja e tij e tradhëton. I tronditur nga kjo ngjarje, ai pëson aksident me makinë dhe humb kujtesën.

13-14 TETOR



Teatri Kombëtar

"Përjetësisht Dashuria"

Autor: Mihal Luarasi
Regjia: Mihal Luarasi
Aktorë: Drita Pelinku, Vangjel Toçe
Ora: 20:00

Sinopsi: Zarina dhe Dioni, një çift pleqsh, të cilët vuajnë vetminë për shkak të emigrimit të fëmijëve. Skenat zhvillohen në dhomën e ndenjes së një shtëpie ku dy bashkëshortët jetojnë vetëm.

13 TETOR



Teatri i Metropolit

"Në aytetin e kafshëve"

Autor: Ilukan Xhagjika
Regjia: Decka Decka
Aktorë: Klesta Shero, Rudi Koçibelli, Brunilda Borova dhe Ilukan Xhagjika
Ora: 10:30

Sinopsi: "Ngjarjet nisin një mëngjes të ftohtë dimri, me zgjimin e tre fëmijëve dhe përgatitjen për të shkuar në shkollë, e më tej me endjen nëpër pyll për të kërkuar shallin e Leas.

Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

Luga
e argjendte

Receta nga Dhurata Thanasi

Omletë me kërpudha dhe fritatë me kungulleshka

Kur mendojmë tryezën e ngrënies shumë prej nesh mund të sjellin në mend pjata të larmshme dhe të shumta, por ia vlen që mendimet dhe fantazitë të mos i kushtohen vetëm vaktit kryesor të ditës që është dreka. Gatime pak më të lehta dhe ndoshta pak më shpejta, i shkojnë për shtat një mëngjesi të diele apo një dite pikniku meqë koha vijon të ngrohtë. Dy recetat e këtij numri do t'ju ngacmojnë në këtë drejtim. Së pari ju sjell një recetë të veçantë omëlete të përgatitur me kërpudha Champignon dhe së dyti Fritatë me kungulleshka dhe gjizë pa kripë.

Omletë me kërpudha Champignon

Qërojmë kërpudhat e pyllit një nga një me një furçë kuzhine, mundohuni të mos i lani. Qepët e njoma i laj dhe i grij hollë mundësisht. Në një tepsi hedhim pak vaj ulliri, dhe shtojmë aty qepët dhe kërpudhat e pastruara. I spërkasim me vaj sipër. I fusim në furë të nxehët 250 gradë sa të nxjerrin lëngun dhe thahen aty brenda. Ndërkohe në perziejmë vezët, qumështin, miellin, ajkën, kripën, piperin, majdanozin, 3 lugë vaj ulliri në një tas dhe i rrahim sa të krijohet një masë homogjene. Pastaj ia hedhim masë tepsisë ku kemi vënë kërpudhat dhe e lëmë sa të mpikset. Në fund e servirim të ngrohtë.

Fritata me kungulleshka dhe gjizë pa kripë

1 qepë mesatare, 2 thelpij hudhër
4 vezë, 20-250 gramë gjizë pa kripë
(ose ricotta) Pak maxhorana, ose në mungesë rigon, Vaj ulliri

Detaj

Përbërësit:
400 gramë kërpudha Champignon
1 gotë e gjysëm qumësht
5-6 lugë miell
4-5 vezë
1 qepë të madhe të njomë ose 2-3 copë
1 tufë majdanoz
kripë, piper
150 ml krem pana
4-5 lugë vaj ulliri



PËRGATITJA

Në një tigan me bazë të gjerë hedhim vajin e ullirit dhe dy thelpijtë e hudhërës. Pasi të jetë nxehur, i heqim thelpijtë dhe shtojmë qepën, të cilën e kemi prerë në feta shumë të holla. Pasi qepa është zbutur disi, shtojmë kungulleshkat, dhe ate prere gjatazi dhe më pas në feta të holla. Ulim pak zjarrin në masën mesatare dhe i lëmë kungujt të zbuten ngadalë duke e mbuluar me kapak tiganin. Herë pas here i trazojmë, në mënyrë që të mos rrezikojmë e të ngjiten dhe digjen. Shtojmë kripë dhe maxhorana dhe pasi jemi bindur që masa ka arritur gatimin e duhur shtojmë gjizën, të cilën e trazojmë ngadalë me qepën dhe kungulleshkat. Presim derisa masa të jetë homogjene dhe më pas shtojmë vezët e rrahura. Kjo behet me ndihmën e një piruni druri me të cilin trazojmë ngadalë masën dhe nuk lëmë shenjë në tigan. Lërimi fritatën të mpikset mirë. Kur jeni bindur që fritata ndahet kollaj nga tigani, kthejeni me ndihmën e një pjate të sheshtë dhe skuqeni dhe nga ana tjetër. Servireni në feta, të vakët ose në temperaturë ambjenti.



Info.com

Kungulli, thesar me vitamina



Meqë kungulli është i pasur me shumë vitamina këshillohet mjaft në gatimin e muhalebive dhe supërave të bebeve të vogla dhe fëmijëve, por dhe të të rriturve. Shumëkush nuk e pëlqen në shije, ose ka vështirësi të mësohet me ngrënien e tij. E mira është që për ta kuptuar që e dëshironi një ushqim është që ta provoni me shumë se 4-5 herë. Nëse nuk ia dilni dot, atëherë është e kotë! Por kam përshtypjen, që kungulli, i gatuar në mënyra të shijshme dhe me praninë e përbërësve të tjerë që të "miqësohen" lehtë me të në gatim e sipër do t'ju pëlqejë! Po këtë mendim kam dhe për bebushat dhe fëmijët e vegjël. Sa më herët në moshë që t'i "edukoni" vogëlushët me të ngrënien e ushyeshëm aq më e lehtë do t'ju jetë "jeta" kur ata të rriten. Jua them këtë, pasi e kam kaluar vetë këtë lloj stresi.

Libri

"E bardhë si qumështi, e kuqe si gjaku"

Leoja është një gjashtëmbëdh letëvjeçar si shumë të tjerë: i pëlqejnë bisedat me miqtë, shëtitjet me motoçikletat dhe jeton në simbiozë të përkryer me iPod-in e tij. Orët që i kalon në shkollë janë një torturë, ndërsa profesorët janë "një specie e mbrojtur, që ti shpreson të shuhet përfundimisht". Kështu që, kur vjen një mësues i ri zëvendësues për historinë dhe filozofinë, ai bëhet gati ta presë me cinizëm dhe me topa të vegjël të lagur me pësh-tymë. Por ky mësues i ri është ndryshe: një dritë i shkëlqen në sy kur shpjegon, kur i nxit nxënësit të jetojnë intensiv-



isht e të kërkojnë ëndrrën e tyre. "E bardhë si qumështi, e kuqe si gjaku" është romani i shkrimtarit Alessandro D'Avenia që vjen në shqip nën përkthimin e : Adrian Beshajt. Duke besuar në një përtëritje moderne dhe vitale të traditës së madhe klasike, D'Avenia, romancier debutues, bëhet aleat me profesorin e ri të liceut - sepse ky është edhe profesioni i vetë autorit - për t'i ofruar një lexuesi pak a shumë të ri ndonjë përgjigje që, si çdo përgjigje e vërtetë, nuk synon të jetë përfundimtare, por as e ndërlyme dhe e nënshtuar.

Vila 12

Cdo të premte Lounge Bar, me çmime 200L Lounge Drink,
Cdo të shtune Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela
Cdo ditë një menu e pasur me gatime shtëpie dhe Italiane.
Cdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpie, dhe një pjatë.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

**RRUGA "MUSTAFA MATHITI",
PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA
Cel. 0696070651**

PROGRAMACIONET E FILM TV

SOT



TOP-CHANNEL

20:06 "Fiks Fare"

20:45 "The Voice of Albania 2"



KLAN

20:10 Te dale ku te dale Serial

21:00 Zone e Lire



VIZION+

20:05 Lugina E Ujqerve - Serial Turk

21:00 BY PASS SHOW



DIGITALB

23:00 "Lamtumira e fundit" Autor

21:15 "Tamam si dashuria"
"Drame

E SHTUNË



TOP-CHANNEL

20:13 "Pop-Channel"

20:45 "1001Pse 2"



KLAN

20:10 Te dale ku te dale Serial

21:00 Mision i pamundur 2



VIZION+

20:05 Mos e beso po deshe

21:00 Al Pazar - Sfaqje



DIGITALB

23:00 Zoti i Unazave-Dy Kullat triller

21:20 "Familjari" Drame

E DIEL



TOP-CHANNEL

20:05 Exclusive

20:45 "Portokalli"



KLAN

20:05 Anatomia E Greit serial premiere

21:00 Mision i pamundur 3



VIZION+

19:48 FBI FILES - Serial

20:45 Apartamenti 2XL



DIGITALB

23:00 ""Takim me Fakërsat"
Komedi

22:00 "Vallezim me Ujnerit" Autor

Jeta e natës

KENGETARJA rikthehet në qytet me pasionin e saj të vjetër. Dy koncerte live në fundjavë që do të sjellin një repertor për tu mbajtur mend gjatë

Vikena Kamenica: Rikthimi në shtëpinë e xhazit!

■ ■ ■ TIRANE

ROVENA RROZHANI

Kush i ka përjetuar netët e nxehta të xhazit, vite më parë në Tiranë nuk mund të mos ndiejë nostalgji për tingujt që dikur dëgjoheshin kaq pak në kryeqytet. Spektatorët e 12 viteve më parë nuk mund të kenë harruar aspak performancat e Vikena Kamenicës, dikur e njohur vetëm në metropol, por gjatë kësaj dekade të lënë pas, e popullarizuar më së miri në mbarë vendin. Ndaj tingëllojnë e etshme të shohësh një rikthim të Vikenës në skenën e klubi, aq më tepër që e kemi dëgjuar zërin e saj të intonuar në tinguj klasikë për caq kohë. Por rikthimi nuk është vetëm për publikun, "rikthimi në qytet" është edhe i këngëtares, kolegëve të saj muzikantë dhe ideueseve të një shtëpie xhazi. Pas 12 vitesh, ajo do të ketë sërish një start të ri, si dikur, por tashmë do të ngrejë siparin e një kalendari koncertesh në vijim.

Vikena Kamenica, prej disa ditësh emri juaj është në një poster koncerti.... Por tashmë në një skenë tjetër, ndryshe nga ajo e Teatrit të Operas dhe Baletit. Ka një lidhje me të shkuarën?

Eshtë e veçantë padiskutim dhe për më tepër shumë e bukur!! Eshtë një nostalgji që tashmë u krijuan kushtet për të rikthyer dhe njëherë të njëjtat emocione!!! Kam qenë gjithmonë e prirur për të thyer sikurse dhe "monotoninë artistike" me evente profesionale. Për t'i dhënë sa më shumë larmi jetës time artistike ashtu dhe publikut.

Jeni zgjedhur të hapni sezonin e një sërë koncertesh në Boom Boom Room. Cfarë do të thotë kjo për ju. Cila është arsyeja e një zgjedhje të tillë?

Në rradhë të parë një kënaqësi për mua dhe për më tepër krenare ku një emër si BOOM BOOM ROOM nga një Pub i vogël live i para 12 vjetëve rikthehet tashmë në një skenë dhe me një kalendër ambicioz për të nisur kështu një sezon koncertor me larmi artistësh shqiptarë dhe të huaj. Ndjehem mirë se kam qenë pjesë e rëndësishme ku për herë të parë u vendosën baza serioze të një muzike shumë profesionale dhe jo thjesht të një muzike live të një lokali! Ndërkohë kjo është ajo që më lumturon që ky emër ka arritur sot deri këtu.

Kthemi pas në kohë. I kujtoni koncertet e para të xhazit?

Me shumë dashuri i kujtoj se kanë qenë vite të bukura sikurse dhe net magjepsëse të një live shumë të veçantë.... Uroj shumë që dhe këto

Performanca e këngëtares në shoqërinë e Keli Band



Viti 2000

Vikena Kamenica, është mezosoprano e Teatrit të Operas dhe Baletit, por fillimet e saj janë si këngëtare e muzikës së lehtë. Në vitet 2000 ai ishte e para këngëtare e xhazit në baret e Tiranës, duke sjellë për publikun muzikën e njohur me interpretime të bukura live

gram mbi klasiket e jazz-it dhe atyre që kanë bërë historinë e kësaj muzike me trajtime pothuajse të reja ku po na çojnë shumë shpejt dhe në plane të tjera të mëvonshme.

Mes muzikës klasike dhe xhazit, cila anon më shumë peshoren tuaj dhe pse?

Absolutisht muzika klasike është oksigjeni im pa të cilin unë nuk do të isha dhe këtu ku jam. Eshtë po kjo që më krijon mundësi teknike profesionale për të realizuar gjithçka që kam dashur dhe pse nuk është e lehtë për të balancuar dy anët e peshores. Nuk jemi shumë që e realizojmë këtë gjë, por në këtë pikë ndjehem e përkëdhelur nga fati që nuk më është krijuar asnjëherë problem për të bërë gjithçka kam dashur si këngëtare lirike ashtu dhe e muzikës jazz etj.. Pas kaq vitesh e diferencoj veten në këtë pikë dhe

netë të para të sjellin po atë eufori dhe emocion.

Nuk ishte shumë në modë dikur të këndoje në club, apo lokale nate. Si ju duket kur kujtoni ato kohë?

Muzika klasike është oksigjeni im pa të cilin unë nuk do të isha dhe këtu ku jam. Eshtë po kjo që më krijon mundësi teknike profesionale për të realizuar gjithçka që kam dashur

E veshitirë. Më duhet patjetër ta them dhe pse ishte pothuajse e pamundur që të kuptonin seriozitetin e asaj që ndodhte dhe vlerën artistike. Deri sa erdhën pothuajse të gjithë për ta prekur dhe për ta kuptuar vetë pa sqarime të tepërta. Më pas doli vërtet në modë dhe filloi epoka e deri më sot e lokalit të muzikës live dhe pse tashmë me zhanre të ndryshme.

Le të vijmë sërish te koncerti? Përse "Back in Toën"?

Shumë e thjeshtë, aspak e komplikuar vetëm se në anglisht.. (qesh) Në atë periudhë daljet e mia

televizive kanë qenë të pakta. Një festival i Këngës i vitit 1996 dhe më pas pothuajse asgjë. Deri sa një ditë e gjë veten pjesë të një bisede dhe vendimi sëbashku me Florian Lularin pianistin e parë të Boom Boom Room-it për të nisur një aventurë nga propozimi i Neritan Hazizaj (ideuesi kryesor) që as vetë nuk e dinim se deri ku do të na çonte....

Suksesi mori hov shpejt dhe ne ishim shumë në modë në Tiranë (dhe pse në qytet të tjera as nuk e dinim çfarë ndodhte këtu). Kështu që shumë thjesht, titulli është "Kthimi në jetën e Natës të këtij Qyteti".

Programi juaj zgjat rreth 1 ore e 30 min. Mund të dimë dicka më shumë rreth këngëve që keni përzgjedhur?

Rikthimi im do të jetë me miq të rinj dhe të vjetër muzikantë!! Siç janë instrumentistat e KELI BAND ku i falenderoj për përkushtimin kryesuar nga Brikel Guga, Emiljano Dhimo me Gentian Shahini, Ilir Durin, Ilir Vorpsi dhe Xhino Daja prej kohësh në tregun artistik. Djem të talentuar ku kemi gjetur gjuhë të mirë bashkëpunimi dhe profesionalizmi. Për një periudhë të shkurtër bazuar dhe në kushtet e mia familjare (prej vajzës së vogël)ne kemi ngritur një pro-

shije dhe me kalimin e viteve dhe të eksperiencës ka fituar një formë të vetën. Por gjithmonë një jam në kërkim për të bërë akoma dhe më mirë... nuk kënaqem kollaj me veten...

Le të flasim pak për të kënduarit live. Cfarë ju nervozon dhe ju qetëson më shumë para një koncerti?

Me profesion primar si këngëtare lirike e kënduara LIVE është pjesë e jetës sime dhe as nuk bën çudi për mua më...Por në rast të këtij lloji është përgjegjësia e daljes përpara një publiku për të dhënë atë që ata presin nga ty dhe nga muzika që ata vijnë për të dëgjuar. Nervozizmi bëhet i pashmangshëm, por para se të dal para mikrofonit ose si dhe në skenë të pamikrofonuar siç ndodh në opera, i them vetes që "erdhi momenti për tu argëtuar". Eshtë e vetmja frazë dhe ndjesi që më bën të çkontraktotem dhe ta lë zemrën të rrahë në ritmin e vet.

Cdo artist duhet të kontrollojë emocionet e tij por pas një rikthimi në një skenë që ju kujton të shkuarën ka ndonjë emocion që del "jashtë" kontrollit?

Ah kjo është e vërtetë ku sikurse ka dhe bukurinë e vet... Kur thuhet Jazz nënkuptohet dhe një LIRI që për ne muzikantët do të thotë shumë se të jep dorë për të vënë gjithë qenien tënde artistike në lëvizje dhe bashkë me emocionet nostalgjike bën një kimi të veçantë.

Kujt ia dedikoni këtë koncert?

Për çdo gjë që unë bëj në Jetë, familja ime zë vendin e parë dhe është e padiskutueshme për mbështetjen e iniciativave të mia. Por në këtë rikthim unë këtë ia dedikoj miqve të mi të cilët prej atyre viteve si dhe sot e kësaj dite janë bërë pjesë e pandashme e jetës sime private dhe artistike... Ju faleminderit MIQ për të gjithë dashurinë, përkushtimin dhe vlerësimin që më keni dhënë e më jepni!!!!



kam filluar ta shijoj siç duhet këtë fakt.

Raporti juaj me xhazin si ka ndryshuar ne vite?

Padiskutim është kultivuar në



Kakavijë, sekuestrohet 17 kg kanabis pranga trafikantit

Një sasi prej 17.6 kilogramë lëndë narkotike kanabis është bllokuar nga policia në pikën kufitare të Kakavijës, pas kontrollit të një automjeti në Sarandë. Policia e Gjirokastrës tha se ka vënë në pranga personin që drejtonte makinën, në të cilën iu gjet edhe një armë pa leje. Efektivët e policisë kufitare të Kakavijës kanë marrë informacion në rrugë

operative se një shtetas nga Saranda me automjetin e tij tip Benz do të trafikonte lëndë narkotike në drejtim të shtetit grek. Mbi bazën e këtyre informacioneve shërbimet e Policisë Kufitare kanë ushtruar kontrolle të rrepta në të gjithë automjetet dhe autobusët që lëviznin në drejtim të Greqisë. Rreth orës 11:00 ka mbërritur një automjet i dyshuar që

mund të transportonte lëndë narkotike. Makina drejtohej nga Angelo Caraj, lindur dhe banues në Sarandë, i cili ishte emigrant në Athinë. Shërbimet e Policisë Kufitare kanë ushtruar një kontroll të imtësishtë në automjetin e dyshuar. Në hasinin e automjetit u gjetën të fshehura disa pako të mbështjella me letër natriban.

Grëfimi i gruas: Bashkohem me burrin, nëse largohet e ëma

Lajmi

Një grua kërkon divorcin në gjykatën e Tiranës, duke argumentuar se dhunohet sistematikisht nga vjehrra. Në padinë e saj shtetësjë, M.Bledaraj 34-vjeçar tregon se vjehrra e hodhi edhe nga shkallët kur mendoi se ishte shtatzënë

Dhunë nga vjehrra kërkon divorcin

34-vjeçarja kthehet te shtëpia e prindërve



pas këtij episodi u largua nga banesa e bashkëshortit, por që ky i fundit që iu lut të rikthehej sërish në banesë. "Ai më thoshte se duhet të kuptoja vjehrrën, pasi ajo ndjehej e vetmuar. Ajo ka nevojë për më shumë dashuri dhe përkushtim nga ne", më thoshte bashkëshorti. Më lutej që ta falja për çka kishte

ketë dashurinë e të birit vetëm për vete. Nuk mund të vazhdoja të qëndroja më në atë shtëpi, pasi bashkëshorti nuk më beson në asnjë fjalë. Ai mendon se unë dua ta shkëpus nga mamaja e tij dhe shpesh herë më ka akuzuar se kam qenë unë ajo që doja të rrihja vjehrrën time. Në këtë situatë nuk mund të jetoj më në atë shtëpi. Ndjehesha keq dhe më dukej sikur po më merrje fryma. Më mirë të vazhdoj të qëndroj me mamanë e tij dhe unë të gjej qetësinë që më ka munguar gjithë këto vite", përfundon rrëfimin e saj M. Bledaraj. Sot

"Vjehrra ime nuk më ka dashur asnjëherë pranë djalit të saj. Më thoshte gjithmonë se nuk isha e denjë për këtë familje dhe se do dëshitoja që ti merrja dashurinë e djalit".

ndodhur dhe të tentoja ta kuptoja. Vendosa të rikthehesha, por asgjë nuk ndryshoi. Konfliktet vazhduan dhe bashkëshorti nuk më besonte asnjë fjalë", tregon M. Bledaraj. Por mungesa e besimit të bashkëshortit dhe konfliktet e herëpashershme me të e detyruar që të kërkonte prishjen e martesës në gjykatë. "Prej disa ditësh jam zhvendosur në banesën e prindërve të mi. Ditën që u largova nga shtëpia i thashë vjehrrës sime se mund të jetoj e qetë dhe të

nis procesi gjyqësor në Gjykatën e Tiranës, ndërsa senanca e parë gjyqësore do të jetë më qëllim pajtimin e çiftit. Paditësja shprehet se në asnjë mënyrë nuk mund të pranojë faljen e bashkëshortit dhe rikthimin për të jetuar në banesë me të vjehrrën. "Nëse ai pranon që vjehrra më ka dhunuar dhe më kërkon falje, unë mund të rikthehem. Por kushti do jetë që të mos jetoj më në një shtëpi me vjehrrën time agresive", kërkon M. Bledaraj.

■ ■ ■ TIRANE
ANXHELA TATO

Kur në vitin 2003 u martua me shtetasin Afrim H., ajo asnjëherë nuk kishte menduar se historia e saj e dashurisë do t'i bëhej ankthi më i tmerrshëm i jetës. E tërë dhimbja iu shkaktua sepse vjehrra nuk e kishin dashur si bashkëshorte për djalin. Ndërsa sot i është drejtuar Gjykatës së Tiranës me një padi shkurorëzimi. "Jam e detyruar që të kërkoj divorcin, pasi bashkëshorti më akuzon si gënjeshitare dhe se dua ta ndaj nga e ëma", nis rrëfimin e saj 34-vjeçarja M.Bledaraj. "Vjehrra ime nuk më dashur asnjëherë pranë djalit të saj. Më thoshte gjithmonë se nuk isha e denjë për këtë familje dhe se do dëshitoja që t'i merrja dashurinë e djalit", shprehet 34-vjeçarja. Por me kalimin e kohës konfliktet e degraduan në dhunë fizike ndaj paditëses M.Bledaraj nga ana e vjehrrës së saj. "Ishte mëngjes dhe bashkëshorti ishte larguar për në punë. Atë ditë u zgjova me herët, pasi po dëgjoja zhurmë në kuzhinë. Kur

futem brenda shikoj vjehrrën që po bërtiste me zë të lartë duke më sharë. E pyes se çfarë e shqetëson dhe pse duhet të ulërinte. Ajo ma kthen duke më ofenduar dhe më godet me një gotë. Fatmirësisht nuk pësova dëmtime, por vetëm një çarje të vogël në ballë. Kur kthehet bashkëshorti në shtëpi, i tregoj për çka kishte ngjarë. Ndërsa vjehrra ime nuk e pranon se më kishte goditur dhe i thoshte Afrimit se unë isha rrëzuar në banjo", tregon paditësja. Por ky nuk

ishte i vetmi episod i dhunës fizike ndaj 34-vjeçares. "Mbam mend që një ditë më mallkoi që të mos lindja kurrë fëmijë, pasi vetëm kështu do më përzinte i biri nga shtëpia. Unë fillova të qesh dhe e provokova, duke e gënjer se isha shtatzënë. Mjaftuan këto fjalë që vjehrra ime të tentonte të më hidhte nga shkallët e pallatit në momentin që po dilja. Por edhe këtë herë përfundova vetëm me një krah të thyer", vijon rrëfimin M.Bledaraj. Ndërsa tregon se

Gjykatë Pushohet çështja për Ervis Gjeçin, gjykata kërkon vendimin

■ ■ ■ TIRANE

Bllokohet procesi gjyqësor ndaj Angelo Prudentinos dhe Ervis Gjeçit. Në seancën e parë gjyqësore prokurori i çështjes ka deklaruar ndaj Gjeçit po zhvilloheshin hetime për akuzën e pastrimit të veprës penale, por kjo çështje është pushuar. Në këtë fazë gjykata ka kërkuar vendimin për të vendosur në lidhje me vijueshmërinë ose jo të procesit gjyqësor. "Ervis Gjeçi ka qenë nën hetim nga prokuroria dhe çështja është push-




Ervis Gjeçi

uar", është shprehur prokurori. "Deri në pritje të vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes, senanca gjyqësore shtyhet", ka përfunduar fjalën e tij gjyqtari. Angelo Prudentino dhe Ervis Gjeçi, kumat i Majlindu Bregut, janë qenë ortakë në kompanitë e basteve "Casino Italia", "Bett Plus" dhe "Betting System Albania" që vepronin kryesisht në fushën e lojërave të fatit dhe lotarive sportive. Pas arrestimit të Albino Prudentinos, djali i tij Angelo shiti aksionet që zotëronte në kompaninë "Betting System Albania".

Policia Vetëvritet aksidentalisht 15-vjeçari, nisin hetimet

■ ■ ■ BULQIZË

Një 15-vjeçar i ka dhënë fund jetës në mënyrë tragjike pasditen e djeshme në fshatin Qeranec të Bulqizës. Nga hetimet paraprake policia bën me dije se adoleshenti Myslym Koçi ka qenë duke ruajtur bagëtitë, në momentin kur është vrarë aksidentalisht me armën të cilën e ka gjetur në kullotë. Ende nuk dihet rrethanat e ngjarjes, ndërkohë policia ka nisur hetimet për zbardhjen e saj. Trupi i pajetë i 15-



vjeçarit është dërguar në morgun e spitalit ku do të nënshtrohet edhe ekspertizës mjeko-ligjore. Pritet që rezultati të ndihmojë forcat e policisë për të zbuluar mënyrën sesi gjeti vdekjen 15-vjeçari. Burime të policisë bënë me dije se vdekja e 15-vjeçarit ka qenë aksidentale. Sipas të dhënave paraprake i mituri ka gjetur një armë dhe ka nisur të lajë me të. Arma është shkrepur aksidentalisht duke i marrë jetën 15-vjeçarit Myslym Koçi. Por nga ana e uniformave blu është ngrihur edhe pista e vetëvrasjes, ndonëse ende nuk ka ndonjë konfirmim.

LAJME SHKURT

■ Pogradec, gjendet i vetëvrasë në banesë

Një person është gjetur i vetëvrasë në Pogradec. Policia bëri me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 16:30. Trupi i pajetë i viktimës është dërguar me urgjencë për në spital, për t'iu nënshtruar ekspertizës mjeko-ligjore. Gjatë kontrollit të banesës së 45-vjeçarit është gjetur një armë gjahu e tipit çifte, të cilën e kishte me leje. Akti i vetëvrasjes është kryer në banesën e 45-vjeçarit me inicialet GJ.DH. Nga ana e bluve kanë nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes.

■ Korçë, përplasje me armë, plagoset një person

Përplasje mes armë në Korçë mes dy grupeve rivale. Një 40-vjeçar ka mbetur i plagosur në këmbë pas një shëri midis disa të rinjve. Ngjarja ka ndodhur në lagjen nr.6 të qytetit të Korçës. Sipas të dhënave të policisë të rinjtë ishin duke pirë në një lokal në momentin që kanë nisur të konfliktohen. I dëmtuari ka mbetur 40-vjeçari Alban Kaçe, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Policia është duke punuar për zbardhjen e plote të ngjarjes. "Rreth orës 14:30 është marrë njoftim se në lagjen nr.6 të Korçës, pas një konflikti për motive të dobëta, një shtetas ka mbetur i plagosur me armë zjarri në këmbë e djathtë. Nga hetimi ka rezultuar se Spartak Seima 21-vjeç ka qëlluar me armë zjarri pistoletë shtetasin Alban Kaçe 40-vjeç", deklarata e policisë.



Trotuaret e Tiranës me puseta të hapura



Banorët e kryeqytetit duhet të bëjnë kujdes edhe kur ecin në trotuar. Kjo sepse pusetat që gjenden në këtë pjesë të rrugës të përcaktuar vetëm për ta nuk mungojnë pusetat e hapura. Siç edhe mund të shihet qartë nga kjo foto ata janë një rrezik për këmbësorët, të cilët mund të përfundojnë në to, duke menduar se

në këtë pjesë të rrugës nuk kanë se kujt t'i ruhen. Madje këto dy puseta ndodhen në trotuarin në qendër të Tiranës, në zonën të "Ushtri i Panjohur" dhe duket se nuk i kanë rënë në as funksionarëve të bashkisë dhe as atyre që merren me mirëmbajtjen e tyre, pasi këto puseta të hapura, pa kapakë ka ditë të tërë që

qëndrojnë në këtë gjendje. Po ashtu, në anën tjetër të kësaj rruge, trotuari është në gjendjen e tij më të keqe, i pa shtruar, me gropa dhe pa pllaka. Në këtë zonë numri i këmbësorëve që lëvizin është tejet i lartë, po ashtu edhe numri i qytetarëve që ecin me motor ose biçikletë, të cilët janë të detyruar të kalojnë në rrugën e automjeteve.

Refrimi i nënës: Të paktën të na jepnin një biletë urbane falas

Lajmi

Gjylbege Hasa, ka 28 vjet që breddh qendër më qendër të shëndetit mendor me vajzën e saj që tashmë është 28 vjeçe. Por nëse deri 18 vjeç ajo kishte se ku ta trajtonte, tashmë që është në moshë madhore, i duhet të paguajë 3 mijë lekë në ditë seancën, ndaj tashmë e ka mbyllur të bijën në shtëpi.

■ ■ ■ TIRANE
ESMERALDA KETA

Të sëmuret mendore 3 mijë lekë një seancë

Familjarët: S'kemi para, i bajmë mbyllur



Gjylbege Hasa me vajzën e saj që vuan nga probleme të shëndetit mendor

Jeta për të ka qenë shumë e vështirë. Jo vetëm se jetojnë në skaj të varfërisë, por edhe sepse nuk gjen dot një vend ku të trajtojë vajzën e saj për problemet mendore që ajo ka. Merr një kemp në vlerën e 9 mijë lekëve të reja në muaj, ndërkohë që vetëm një seancë kushton 3 mijë lekë të reja. Në një intervistë për "Shqiptarja.com" ajo rrëfen se për këtë kategori duhet të miratohet statusi, që të përfitojnë së paku një biletë urbane falas.

Sa vjeç është vajza juaj dhe nga se vuan?

Vajza ime aktualisht është 28 vjeçe. Që kur lindi, lindi me një deformimin të shpatullës së djathtë e cila më pas i preku një nerv qendror dhe e la me zhvillim të vonuar.

E keni trajtuar ju vajzën tuaj?

PO vazhdimisht. Deri në moshën 18 vjeç e kam pasur te qendra e pëllumbave, por pas kësaj moshe kam bledhur sa andej këndeje për të gjetur një vend ku ta kuroj.

Po përse? Nuk ka qendra të specializuara për këtë?

Qendra shtetërore nuk ka. Deri para ca kohësh e çoja tek një qendër private që ishte këtu në Tiranë, por tani ajo është zhvendosur në fshatin Shesh të Tiranës, diku matanë Kombinatit dhe plus që i ka tarifën e larta.

Sa kushton një seancë?

Po e kanë 3 mijë lekë të reja ditën dhe vajza ime ka nevojë së paku tre herë në javë për terapi, e mira ishte ta çoja çdo ditë, por edhe me tre herë në javë do të isha e kënaqur.

Ju e dërgoni aktualisht vajzën në këtë qendër?

Jo! Ku t'i gjej unë kaq shumë lekë, plus që për të vajtur deri atje duhet të paguash edhe furgonin çdo ditë. Ne po përpiqemi të mbijetojmë dhe jo të jetojmë.

U bënë nja dy vjet që e mbaj në shtëpi. Nuk kam ku ta çoj. Shteti nuk ka qendra të tilla, në privat po nuk ia dal dot, ndaj e kam mbyllur në shtëpi.

A merr ndonjë pension shtesë për sëmundjen që ka vajza juaj?

PO tani ku po e dërgoni?

Agjencia e akreditimit

Universitetet, pa akredituar

■ ■ ■ TIRANE

Asnjë prej universiteteve publike në Avend nuk i është nënshtruar procesit të akreditimit. Ndryshe nga privatët, që janë të shumtë që kërkojnë akreditim për institucionet dhe programet e tyre, për këtë vit vetëm një shkollë e lartë publike ka kërkuar t'i nënshtrohet këtij procesi, ndërkohë që sipas ligjit ri të arsimit të lartë vitin tjetër duhet ta bëjnë të gjithë shkollat e larta publike. Drejtori i Agjencisë Kombëtare për Akreditimin, Avni Meshi, u bën thirrje në veçanti universiteteve të rretheve, të cilat kanë qëndruar indiferentë të nisnin këtë proces të rëndësishëm. "Ky detyrim ligjor është pas ligjit të "Arsimit



të lartë" në vitin 2007, i cili ka dhe anën tjetër të akreditimit ciklik, një herë në gjashtë vite, do të thotë që, universitetet

që janë hapur më herët sesa 2007 si duket quhen të mirëqenë si të akredituar përpara dhe i bie që vitin tjetër ata të kërkojnë riakreditim", - shpjegon Meshi. Sipas tij, akreditimi mund të kryhet edhe nga ekspertët të jashtëm. "Madje, një iniciativë të tillë do të merrte universiteti i Tiranës, por deri tani premtimi ka mbetur në nivel deklarata. Këto kanë qenë iniciativat të mbetura në tentativë. Nuk ka asnjë kërkesë në agjencinë tonë", - shprehet kreu i agjencisë së kombëtare të Akreditimit, Avni Meshi. Për specialistët e huaj universitetet duhet të paguajnë gati dyfish të tarifës. Nëse akreditimi bëhet nga ekspertët vendas ai kushton gati 300 mijë lekë ndërsa me specialistët të huaj ai shkon rreth 600 mijë lekë.

SHËNDETI MENDOR PËR 9 MUAJ E KËTIJ VITI NË TIRANË

- 15 mijë vizita për 9 muajt e parë të këtij viti
- 12.000 vizita janë bërë për të rritur
- 2400 vizita i përkasin moshave peditrike
- 40 vizita në ditë realizon çdo qendër
- 590 kartela klinike janë hapur në qendrën e shëndetit mendor nr.1 për pacientë kronikë me skizofreni apo çrregullime psikotike dhe 910 të tjerëve me çrregullime afektive
- 1792 paciente kronikë janë kartelizuar te qendra nr.2
- 1740 të rritur janë kartelizuar në qendrën nr.3
- 2290 fëmijëve u është hapur kartelë klinike
- 268 janë ata me spektrin autik

veçantë për kategorinë ku bën pjesë edhe vajza juaj?

Statusi është një gjë që ne e kemi kërkuar vazhdimisht. Është premtuar, por asnjëherë nuk është bërë gjë. Dhe kjo do të ishte një gjë e mirë për këtë kategori, pasi ne jetojmë në kushte shumë të këqija. Të paktën do të mund të merrnin nga një biletë urbane falas. Shteti duhet të vërdorë mbi këta, pasi kjo kategori nuk mund të lihet rrugëve. Kur unë të vdes kush do të kujdeset për vajzën time??

veçantë për kategorinë ku bën pjesë edhe vajza juaj?


Statusi është një gjë që ne e kemi kërkuar vazhdimisht. Është premtuar, por asnjëherë nuk është bërë gjë. Dhe kjo do të ishte një gjë e mirë për këtë kategori, pasi ne jetojmë në kushte shumë të këqija. Të paktën do të mund të merrnin nga një biletë urbane falas. Shteti duhet të vërdorë mbi këta, pasi kjo kategori nuk mund të lihet rrugëve. Kur unë të vdes kush do të kujdeset për vajzën time??

LAJME SHKURT

■ **Aksidenti i Himarës, kthehet në shtëpi Florije Peçi**
Florije Peçi, studentja e Elbasanit që u aksidentua në Himarë, është rikthyer në shtëpi në gjendje të mirë shëndetësore. Vajza 21-vjeçare nga Librazhdi ka fituar betejën me plagët e rënda që kishte marrë gjatë këtij aksidenti tragjik dhe i është bashkuar dhe familjes së saj. Ajo po kurohej që prej 5 muajsh në një klinikë të specializuar në Austri dhe tashmë gjendja e saj shëndetësore është përmirësuar plotësisht, gjë që ka bërë të mundur edhe ardhjen pranë familjes së saj. Në aksidentin tragjik të 21 majit në Himarë, humbën jetën 11 studente të Elbasanit, i fejuari i njëres prej vajzave dhe drejtuesi i automjedit.

■ **Masteri part-time, nisin sot aplikimet**
Duke filluar nga dita e sotme, e deri në fillim të nëntorit, të gjithë të interesuarit për të kryer studimet e ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, kanë mundësi që të aplikojnë duke dorëzuar dosjen me dokumente. Sipas MASH aplikimet do të nisnin nga ora 08:00 e ditës së sotme, e për të vijuar për tre javë me radhë. Nga të gjithë ata që aplikojnë do të kenë mundësi të përfitojnë plot 4665 studentë të sadoiplomuar, numër që përkon me kuotat e miratuara nga qeveria për studimet "Master profesional", me kohë të pjesshme për vitin e II akademik 2012-2013.

■ **MASH, 322 bursa për nxënësit romë**
Qeveria ka miratuar projektin pilot për nxitjen e të nxëniet për fëmijët romë. Sipas këtij projekti pilot që më pas do të shtrihet në të gjithë vendin, MASH jep 322 bursa për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri" në Korçë. Vlera e bursës është 74.4 lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës, që do tu ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës është në formën e shërbimit ushqimor ditor. Drejtorja Arsimore Rajonale, Korçë, në fillim të vitit shkollor duhet të dërgojë pranë bashkisë Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfitues të bursës të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.



Koncerti

"LA FAME DI CAMILLA" grupi rock puljez, i drejtuar nga shqiptari Ermal Meta më 10 tetor dha një koncert në Londër në klubin historik Dingwalls

Ermal Meta dhe grupi rock puljez befasojnë Londrën

Mori pjesë në Sanremo me këngën "Buio e Luce"



Në foto: Lideri i grupit "La fame di Camilla" Ermal Meta

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Koncerti i grupit rock puljez "La fame di Camilla" në klubin historik Dingwalls dha në kuadrin e mbrëmjes me titull "Puglia Sounds In London". Grupi drejtohej nga Ermal Meta, djaloshi shqiptar me origjinë nga Fieri, që i ngjiti shumë shpejt hapat e suksesit Itali. Ermal Meta dhe grupi i tij në Londër ishin pjesë e mbrëmjes dedikuar Puglias, e cila u prit me entuziazëm. Dhe grupi prezantoi për herë të parë në Tqcom24 videoklipin e këngës së re "Vetëm një gjurmë". Grupi muzikor "La fame di Camilla" ka lindur në vitin 2007 dhe sot konsiderohet si një nga më premtuesit në panoramën muzikore italiane. Ashtu siç e kishin parashikuar kritikët dhe specialistët e muzikës, brenda një kohe të shkurtër grupi rok pop doli nga hijja amatore dhe mbërriti në kanalet më të rëndësishme të muzikës. Lideri i grupit është i riu shqiptar Ermal Meta, i cili prej 16 vjetësh ishte me banim në Itali. Në diskutim e parë të grupit, Ermali nuk ka harruar të fusë diçka nga Shqipëria. Vepra e tyre e parë, e prodhuar nga Universal Music, mbyllet me këngën "Në dorën tënde" të kënduar në shqip. Tingujt emocionues të kitarës krijojnë një atmosferë të ëmbël, me tone nostalgjie. Jo më kot një kritik e ka cilësuar muzikën e grupit "La Fame di Camilla" si një përkëdhelje plot nostalgji. Ermal Meta me "La Fame di Camilla", gjithashtu ka marrë pjesë në Sanremo 2010 këngën "Buio e Luce" të shkruar e të kënduar nga Ermali. "Errësira dhe drita janë bij të diellit" thotë kënga, për të thënë që mund edhe të fshihesh ndjenjat për dikë, por errësira nuk mund të pengojë kthimin e dritës, arsyeja nuk mund të fshijë identitetin e zemrës. Me poezinë e tekstit, melodinë ëndërrimtare, kjo këngë e ka bërë publikun për vete. Në një intervistë dhënë për "Bota Shqiptare" ai tregon si nisi rruga e tij drejt suksesit.



grupit që ka studiuar më pak.

Si u krijua ky grup?

Grupi ka lindur para tre vjetësh, fare rastësisht. U takuam në një dyqan veglash muzikore ku punonte njëri prej nesh ku, domosdo, shkonim gjithmonë. Aty në dyqan filluam të flisnim me njëri-tjetrin dhe kuptuam që idetë tona muzikore kishin shumë pika takimi. Menjëherë vendosëm të bëjmë një provë në studio live për të kuptuar nëse vërtet mund të funksiononim

së bashku. Qe diçka që as vetë nuk e prisnim: shkoi shumë shumë mirë. Nga prova e parë punuam në studio së bashku e pas dy muajve dhamë koncertin e parë. E që atëherë nuk jemi ndalur më, kemi bërë gjithnjë koncerte. E kam parë vërtet shumë pak shtëpinë këto dy vitet e fundit. Të gjithë anëtarët e grupit vinim me një eksperiencë të gjatë mbi shtatulla, prandaj edhe ia dolëm që të jepnim thuajse menjëherë koncerte, pasi e dinim se ç'ishte muzika live. Të kompozosh e të regjistrosësh është një gjë, por të vësh në skenë këngën është tjetër gjë. Duhet respektuar një kohë, duhet interpretuar, duhen dhënë ngjyrimet e duhura, nuk mjafton të luash me saktësi pjesën në kitarë apo bas apo bateri. Duhet që të katërt të jemi në sintoni të plotë, si një trup i vetëm. Për të bërë këtë ose ke shumë eksperiencë ose je shumë me fat. Dhe unë mendoj që fati nuk ka të bëjë fare me rastin tonë.

Një artistë të tjerë shqiptarë në Itali?

Po kam njohur personalisht një grup në Firence që bënin rap, nuk di nëse janë akoma bashkë. Ishin një përzierje shumë interesante,

shumë e bukur: kitaristi ishte maroken, dy këngëtarët shqiptarë dhe bateristi argjentinas, dhe bashkë krijojnë diçka shumë të bukur, mbresëlënëse. Elsa Lila është, për shembull, këngëtare shumë e mirë, nga ana teknike është e shkëlqyer dhe ka një zë që më pëlqen shumë. Por unë kam shijë të tjera artistike.

Grupi ka lindur para tre vjetësh, fare rastësisht. U takuam në një dyqan veglash muzikore ku punonte njëri prej nesh ku, domosdo, shkonim gjithmonë

A mendon të shkosh të këndosh një ditë në Shqipëri?

Do të shkoj patjetër. Duhet një punë e madhe organizative, nuk është e thjeshtë pasi çdo gjë duhet të jetë në vendin e vet. Të ishte për mua merrja kitarën e shkoja, por është një strukturë e tërë që duhet të funksionojë. Besoj se koncerti është në brendësi të një festivali, që zgjat për 2-3 ditë.

Po për në festival të Tiranës a mendon të shkosh, në mos për të kënduar, për ta prezantuar siç kanë bërë Elsa Lila apo Alban Skënderaj?

Jo, jo, jo (qesh me të madhe). Nuk jam i zoti as të jap një intervistë jo më të prezantoj një festival të tërë. (Intervistoi Ketii Biçoku. Botuar me shkurtime)

Pas Totozanit

Berisha këmbëngul për ndryshimin e Himnit

Kryeministri Sali Berisha, dje në mbledhjen e Komitetit Ndërmisor për 100-vjetorin e Pavarësisë ka këmbëngulur për ndryshimin e Himnit Kombëtar. Ky është rasti i dytë që propozohen ndryshime në Himnin Kombëtar, pas propozimit të Avokatit të Popullit Iglj Totozani. Rreth pesë muaj më parë propozimi i Avokatit të Popullit z.Totozani ishte që fjalët "kush është burrë nuk frikësohet" të bëheshin "burrë a grua nuk frikësohet" me pretekstin e emancipimit të gruas. Mirëpo kryeministri S.Berisha dje deklaroi se është dakord me propozimin që Himni Kombëtar të kthehet në formën e tij të plotë, origjinale. Edhe pse akademikët më të njohur dhe personalitetet më të njohur kundër propozimit të avokatit të popullit Iglj Totozani, dje z.Berisha këmbënguli me

forcë për ndryshime të tjera të Himnit. "Himni kombëtar duhet të rikthehet në formën e tij të plotë. Apeli i shqiptarëve tek Zoti është apeli më i drejtë sepse Zoti dhe Kombi janë një e të pandarë. Në sensin që Kombi dhe dashuria për kombin dhe për vendin buron nga fryma e Zotit. Ndaj unë jam që të shihen të gjitha modalitetet se si të kthehet kjo strofë e përzënë nga stihia ateiste. Të bisedohet edhe me Akademinë, të bisedohet me institutin, të bisedohet edhe me kompozitorët dhe himnin mendoj unë duhet të kthehet në variantin e tij të plotë ashtu sikurse e shkruajti rilindasi ynë i madh Aleksandër

Sotir Drenova", tha Kryeministri Sali Berisha. Pra, i pari, z.Totozani kërkonte një ndërhyrje pa respektuar të drejtën e autorit, i dyti z.Berisha kërkon një ndërhyrje duke i rikthyer autorit.



Fatmir Koçi

Filmat e diktaturës në San Francisko

Projekti më i ri i Arkivit Qendror Shqiptar të Filmit, "Ki nemaja shqiptare", prezantohet në një aktivitet të Oddball Films në San Francisco Media, Kaliforni, më 13 tetor. Projekti prezantohet nga këshilltarja e AQSHF-së dhe drejtoresha e projektit, dr. Regina Longo. Me këtë rast do të shfaqen për publikun materiale arkivale nga fondi i kronikave të AQSHF-së si filmi dokumentar "In the land of eagles", "Në tokën e shqiponjave" i regjistruar nga Eljan Koçi, filmi i shkurtër dokumentar "Mushrooms" "Kërpudhat" nga Eljan Koçi dhe Gylar Mydyti. Fatmir Koçi ka treguar se dokumentari i tij "Në vendin e shqiponjave" do të jetë filmi i parë me të cilën Shqipëria do prezantohet nesër në San Francisko të SHBA-së. Sipas tij, duke nisur nga arkivat imazhet e para të Shqipërisë në ekran datojnë në vitin 1914. Shqipëria ka 100 vjet të historisë kinematografisë.



toresha e projektit, dr. Regina Longo. Me këtë rast do të shfaqen për publikun materiale arkivale nga fondi i kronikave të AQSHF-së si filmi dokumentar "In the land of eagles", "Në tokën e shqiponjave" i regjistruar nga Eljan Koçi, filmi i shkurtër dokumentar "Mushrooms" "Kërpudhat" nga Eljan Koçi dhe Gylar Mydyti. Fatmir Koçi ka treguar se dokumentari i tij "Në vendin e shqiponjave" do të jetë filmi i parë me të cilën Shqipëria do prezantohet nesër në San Francisko të SHBA-së. Sipas tij, duke nisur nga arkivat imazhet e para të Shqipërisë në ekran datojnë në vitin 1914. Shqipëria ka 100 vjet të historisë kinematografisë.

NGA "BOTA SHQIPTARE"

"...Ermal Meta është 30 vjeç, jeton rreth 16 vjetëve në Bari ku ka mbërritur me familjen e tij nga Fieri. Në Itali ka sjellë me vete edhe pasionin për muzikën, me të cilën është ushqyer që i vogël, falë së ëmës, mësuese violine. Ermali këndon, i bie pianos dhe kitarës. Siç tregon edhe vetë i janë shumë familjarë edhe tingujt, të bezdisshëm për shumëkënd, të akordimit të një instrumenti. Ka nisur të studiojë pianon në rreptësi e të lindjes që në klasë të parë, por rreptësia e mësuesve dhe kokëfortësia e tij nuk shkuan dakord për më shumë se dy vjet. E la studimin por nuk braktisi pasionin e tij për muzikën.

Kush janë pjesëtarët e grupit tënd?

Grupi ynë përbëhet nga katër vetë, unë këndoj dhe luaj në kitarë e piano, dhe tre djem nga Bari: Giovanni Colatoriti kitarist, Emanuele (Lele) Diana baterist dhe Dino Rubini basist. Të tre djemtë kanë vite të tëra studimesh mbi shtatulla, praktikisht unë jam anëtar i

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gozhdë Bullona sh.a. - Lqj. Nr.5 Kavajë - NIFP : J62903812R

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë aksionerët e "Gozhdë Bullona" Sh.a. Se më datë 2 nëntor 2012 ora 09:00 në ambientet e shoqërisë zhvillohet mbledhja e jashtëzakonshme e asamblesë, me rend dite:

1. Ndryshime në statutin e shoqërisë,
2. Të tjera...

Vo. Për çdo sqarim për mbledhjen, aksionerët mund të paraqiten pranë drejtorisë.



Nobel 2012

FITUESI është i dyti shkrimtar kinez që fiton Nobelin. Kreu i Akademisë Suedeze, Peter Englund, e konsideron të parin. Fituesi i vitit 2000, Gao Xingjian, mbante shtetësinë kineze

Mo Yang, emri surprizë i Nobelit

Nuk u lakua në asnjë listë si kandidat i mundshëm

TIRANE
DHURATA HAMZAI



Shkrimtari i njohur kinez, Mo Yan

Shkrimtari i njohur kinez, Mo Yan (1955) është fitues i çmimit "Nobel" për letërsi të këtij viti, ka deklaruar Akademia Suedeze. Sipas kësaj Akademie shkrimtari Mo Yan "është autori i parë kinez që ka fituar ndonjëherë çmimin Nobel në letërsi". Kreu i Akademisë Suedeze, Peter Englund, duke njoftuar fitoren e tij dhe mesditë, tha se "me një realizëm alucinant", Mo Yan "bashkon historinë kombëtare me atë bashkëkohore. Sipas "The Guardian", Akademia Suedeze shpall se "fitorja e bën atë shkrimtarin e parë kinez që fitoi Nobelin në historinë e tij 111-vjeçare". Megjithatë një tjetër autor kinez Gao Xingjian ka fituar Nobelin në vitin 2000, dhe vendlindja e tij është Kina, ai është konsideruar si një qytetar francez. Shkrimtarit Mo Yan, çmimi Nobel iu dha "për Përshkrimet e pasura dhe me vërtetësi epike të jetës fshatare në Kinë dhe për kryeveprat e tij biografike", shkruan "The Guardian". Ndryshe nga fituesit e mëparshëm, duke përfshirë Samuel Beckett, Doris Lessing dhe vitin e kaluar poetin suedez Tomas Tranströmer, kreu i Akademisë Suedeze, Peter Englund, ka theksuar dje në mesditë se "shkrimtari Mo Yan, tërhiqet nga mjedisit e tij fshatar, dhe nga traditat popullore prej të cilës i kanë mbetur kujtime nga fëmijëria e tij". Ai e la shkollën në moshën 12 vjeçare dhe shkoi për të punuar në fushë. Më pas me shumë vështirësi, ai mund të fitonte një arsim ushtarak. Emri i vërtetë i tij është Guan Moye dhe e ka zgjedhur pseudonimin letrar si një formë "satire" ndaj gjyshes së tij. Filmi i realizuar nga Zhang Yimou ka fituar "Ariun

e Artë" në Festivalin e Berlinit. "Ai shkruan rreth fshatarësisë, për jetën në fshat, për njerëzit që luftojnë për të mbijetuar, të cilët duke luftuar për dinjitetin e tyre, ndonjëherë fitojnë, por në shumicën e kohës humbasin", tha Peter Englund dhe në deklaratën e tij, duke shtuar se "Vlerësimet magjike janë përdorur për të, por unë mendoj se e nënvlersojmë kur thonë se realizmi i tij është një gjë që e merr nga Gabriel Garcia Marquez, por ai ka diçka që është tërësisht e tij, e mbinatyrshme". Mo Yan është vlerësuar nga kritika se ka një shkrim konciz me një logjikë të fort morale, një stil imagjinar dhe i paraqet vepra me ekstravagançë të guximshme. Ai është i njohur edhe

për faktin se veprat e tij mbretërojnë në tregun letrar përratës, ndërsa shpesh herë e quajnë edhe si "Kafka kinez". Romani më i fundit i autorit, Mo Yang rrefen një histori që lidhet me pasojat e politikës së zbatuar për një fëmijë të vetëm për çdo çift në Kinë. Mo Yan, emri me të cilin firmos romanet e tij, do të thotë "ai që nuk do të flasë", sepse gjyshja e tij i thoshte gjithnjë të pushonit, ngaqë ai ishte një fëmijë shumë lufazan. Mo Yan ka lindur në Shandong më 1955-n. Veprat e tij janë mbushur me histori që tregojnë për burra që kanë pasur jetë të vështirë, për varfërinë ekstreme dhe punën në kampe, të cilët kanë kaluar përmes revolucioneve dhe luftërave e që kanë pësuar dhunën ekstreme.

Parashikimet

Kadare që s'emi mori sërish Nobelin

Këtë herë emri i një shkrimtari kinez në listën e Nobelit ka qenë surprizë edhe për mediat më prestigjioze që kanë qenë më pranë burimeve të Akademisë së Nobelit. Një muaj më parë romancier i japonez Haruki Murakami dhe shkrimtari shqiptar Ismail Kadare parashikoheshin si dy garuesit më të fuqishëm për çmimin Nobel në Letërsi. Në listën e parashikimeve për rreth një muaj përfliteshin si kandidatë shkrimtari japonez Haruki Murakami dhe Ismail Kadare. U fol shumë në mediat ndërkombëtare ditët e fundit se publikimi i letërkëmbimeve në prag të Nobelit 2012 nga zozja Nexhmije Hoxha, e veja e Diktatorit Enver Hoxha, pas paditjes në gjyq nga Kadareja për kthimin e dorëshkrimit "ka ndikuar në vendimin përfundimtar të jurisë së Nobelit". Por, ende nuk dihet a është marrëdhënia e Ismail Kadaresë me diktaturën një nga kriteret e kësaj jurie.



Isamil Kadare

Galeria FAP

Ardian Isufi ekspozon "Pa titull në kohë"

TIRANE

Artisti i njohur Ardian Isufi, në vijim të punës së tij këtë herë vjen me një ekspozitë personale të cilën e ka titulluar "Pa titull në kohë". Artisti duket se nuk ndalet për të sjellë sa më shumë projekte artistike, të cilat i shërbejnë jo pak gjallërisë artistike në kryeqytet. Ekspozita do të hapet më datë 18 tetor dhe të vijojë të qëndrojë e hapur për publikun deri më 28 tetor në mjediset e galerisë FAP të Universitetit të

Arteve. Ekspozita që vjen si projekt personal i artistit dhe pedagogut të Fakultetit të Arteve Pamore, Ardian Isufi në galerinë FAP, por ai këtë herë ka treguar vëmendje për 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, duke ia shtuar dhe më shumë rëndësinë artistike. Artisti Ardian Isufi është një ndër piktorët më të njohur shqiptarë. Herë pas here me projektet e tij ka treguar se angazhimi



në jetën artistike nuk është i vogël, ndërsa krijimet e tij janë vlerësuar jo pak dhe jashtë kufijve shqiptarë.

Muzeu Kombëtar

Vlora e Pavarësisë sjell harta e dokumente

TIRANE

Arkitecti Piro Stefa ka çelur Muzeut Historik Kombëtar ekspozitën "Vlora në shekullin e Pavarësisë", që do të qëndrojë e hapur deri më 14 tetor. Ekspozita shpallor rreth 400 gravura, vizatime, harta, foto të vjetra dhe kartëpostale, që paraqesin Vlorën në historinë e saj para dhe pas ditës historike të shpalljes së Pavarësisë. Këto pjesë të koleksionit të arkitek-



tit Piro Stefa përbëhet nga: harta mesjetare të realizuara nga lundëtarë e udhëtarë, vepra arti, foto të kohës dhe kartëpostale të vjetra, të cilat pasqyrojnë qytetin, pazarin, jetën e zakonshme qytetare, arkitekturën, objektet religjioze dhe të kultit, bregdetin, rrugën Vlore-Skelë, Sheshin e Flamurit, ekonominë, luftërat dhe të huajt, fate njerëzish e kostume, nostalgjinë për qytetin e vjetër që ndryshon dhe humbet si rezultat i zhvillimit, etj.

HOROSKOPI

Dashi
Sot dita nuk do ketë vetëm premtime por në të njëjtën kohë do ndjehet se nga tjetër kalohet në vesra. Dita nga dëshirat tuaja sot fillojnë të marrin një drejtim të qartë dhe realizimi. Udhëtime me rreth të dashur dhe plane për fillime të reja në projektet tuaja do kenë përparësi në ditën e sotme.

Demi
Do keni një ditë ku zotësia juaj, por edhe shanset që do ju japin do bëjnë që të keni një sukses të madh në çështjet ekonomike. Do keni mundësi të bëni blyerje të suksesshme apo të qetësoni në problemet familjar që kënet me ndryshime apo me ekonominë.

Bimëkëmbë
Për ju dita e sotme do jetë dita e vlerës në funksionin të planeve tuaja. Çdo gjë që ka të bëjë me jetën personale apo me ambicie personale do ketë një zhvillim pozitiv drejtë zgjidhjes së tyre. Ka mundësi të keni sukses në një çështje sentimentale.

Gjafortja
Dita e sotme për ju do rezultojë një ngjizim apo një dalje nga konfuzioni, i cili ju ka përfshirë në shumë aspekte të jetës tuaj. Një çështje ekonomike do sjell fitime në lidhje me punën tuaj dhe në disa raste të vécanta mund të dëshmohet përfitimi.

Luani
Ka shumë mundësi që sot të jeni mbështetur dhe përkatshëm që keni kërkuar gjatë gjithë kësaj periudhe nga rasti dhe përkatshëm tuaj. Mund të keni një jetë të reja të cilat do rezultojnë shumë të mira dhe të gëzueshme si në shoqëri ashtu dhe në dashuri.

Virgjëresha
Dita e sotme do jetë e vécantë për ju sidomos në lidhje me karrierën dhe emrin tuaj si dhe publikimin e punës tuaj. Ka shumë mundësi të fitoni një proces të rëndësishëm për ju apo të zini një pozicion të rëndësishëm në bashkëpunimet apo punën tuaj.

Peshorja
Kjo periudhë duhet shfrytëzuar nga ana juaj përsa i përket planeve e mund të keni përsa i përket studimeve kontakte me jashtë, udhëtimeve apo marrëveshjeve nga më të rëndësishmet për të ardhmen tuaj. Do ndjehni shumë të motivuar.

Akrepi
Kjo periudhë më shumë se kurrë mund të jetë me marrëdhënie ekonomike. Në diskutimet apo llovet që do keni përsa i përket çështjeve ekonomike ka mundësi të shikoni të ardhurat tuaja të shohin por edhe mundësi për të zgjeruar marrëdhënet tuaja.

Shigjetari
Dita e sotme do ketë të bëjë në shumë në lidhje me marrëdhënet që keni me të tjerë. Marrëdhënia në çift me sa duket do jetë me të vlerë e sigurtë dhe në rast problemeve dhe në se keni dëshirë për të marrë vendime serioze këto do të bëni tan.

Bricjapi
Kjo ditë do ketë të bëjë në përgjithësi me jetën tuaj të përditshme dhe sidomos me punën. Do keni mundësi të bëni ndryshime apo të vendosni për një ndryshim në lidhje me punën. Do keni akoma dhe mundësi që të rrisni të ardhurat tuaja.

Ujori
Dita e sotme do jetë një ditë me të vërtetë e mrekullueshme përsa i përket pasigjeve erotike. Do keni mundësi të një marrëveshje të mirë përsa i përket një bashkëpunimi dhe do ndjeheni shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim. Lajme të mira për marrëdhënet në çift nuk mungojnë.

Peshqji
Dita e sotme do ketë të bëjë më shumë me çështje që lidhen me shpalljen apo të afirmimit. Do keni mundësi të punësoheni nga dikush i afërt apo të rrisni të ardhurat e një biznesi familjar. Nuk përjashtohet mundësia e një ndryshimi në ambientet e shtëpisë apo një zhvendosje.

MERI SHEHU
0900 673 4000

LAJME
NGA BOTA

■ Gjyqi me kazinonë, shqiptari merr 1 milion euro
Shqiptari Behar Merlaku nga Maqedonia i cili jeton dhe punon në Zvicër, ka arritur të përfundojë konfliktin me "Casino Austria". Ditën e djeshme në Gjykatën Feldkirch Behar Merlaku ka pranuar të marrë 1 milion euro dhe të përfundojë "luftën" për 42 milionë. Afër një vit më parë Behari kishte fituar 42 milionë euro, por që "Casino Austria" kishte shpërgjuar se automati i lojërave kishte një problem në "Softwer" për atë edhe kishte refuzuar këtë pagesë. Ditën e djeshme, gjykimi ka përfunduar vetëm pas pak minutave pasi Behari kishte shpërgjuar gjykatës se "ka përfunduar këtë gjyq" pas një marrëveshje private me "Casino Austria".

■ Obama autokritik për debatin e parë televiziv
Presidenti amerikan, Barack Obama pranoi dje se debati i parë televiziv me kandidatin republikan, Mit Romney, më 3 tetor ishte një dështim për atë, duke theksuar se bazat themelore për zgjedhjet e 6 nëntorit nuk kishin ndryshuar. "Ishte një mbrëmje e mirë për guvernatorin Romney. Ajo nuk ishte mbrëmja ime. Nuk është hera e parë që ndodh kjo", deklaroi Obama për stacionin televiziv ABC, duke i referuar takimit të organizuar në Denver, prej të cilit Romney fitoi pikë në sondazhe.

■ Irani në kolaps ekonomik
Kompania shtetërore ajrore e Takhkistanit lu ka bashkuar avio-kompanive të tjera, duke suspenduar fluturimet për në Teheran, për shkak të zhvlerësimit të valutës kombëtare iraniane, rialit. Zëdhënësi i kësaj kompanie tha dje se fluturimi i radhës për në Teheran, i planifikuar për datën 13 tetor, është anuluar. Ende nuk dihet se kur do të mund të rifillojë linja Dushanbe-Teheran, e cila mban fluturime dy herë në javë.

■ Çekia shpreson t'i shesë aeroplanë Irakut
Kryeministrat e Republikës Çeke dhe të Irakut thanë se vendet e tyre janë duke negociuar për mundësinë e një marrëveshjeje për ta furnizuar ushtrinë e Irakut me aeroplanë ushtarakë. Pas takimit me homologun e tij irakian, kryeministri çek, Petr Nečas tha se ministrat e mbrojtjes së të dyja vendeve pritet të diskutojnë për hollësitë. Ministri çek i mbrojtjes, Aleksander Vondra tha se vendi i tij mund t'i shesë deri në 28 aeroplanë luftarakë dhe të trajnimit.

■ Dyshime për armatime në aeroplanin sirian të udhëtarëve
Aeroplanët e avionit të Luftës së Turqisë kanë urdhëruar sot një aeroplan sirian të udhëtarëve, i cili kishte shkalur hapësirën ajrore të Turqisë, që të ulet në aeroportin e Ankarasë, njoftoi televizionit shtetëror TRT. Aeroplani i udhëtarëve Airbus 320 fluturonte nga Moskua për në Damask, ndërsa kur hyri në hapësirën ajrore të Turqisë, atij ia prenë rrugën avionët luftarakë turq F16, duke e urdhëruar që të aterojë në aeroportin Esenbog. Sipas televizionit turk, dyshohet se aeroplani i udhëtarëve transportonte armatim të rëndë.

■ Në dy shpërthime bombash, 13 të vrarë
Në dy incidente të ndara me bombë në provincën Balochistan të Pakistanit kanë mbetur dje të vrarë të paktën 13 persona. Zyrtari i lartë i policisë, Ghulam Ali Lashari tha se bomba e parë shpërtheu jashtë një tregu në qytezën Sibi, duke vrarë 10 persona dhe plagosur 24 të tjerë. Shpërthimi gjithashtu shkatërroi edhe disa dyqane. Disa orë më vonë, rreth 200 km më larg, automjeti, që bartte zyrtarë të policisë së qytetit Dera Bugti, hasi në një bër bombë të vendosur në rrugë.

■ Vritet shefi i sigurimit i ambasadës amerikane në Jemen
Një person i armatosur ka vrarë shefin e sigurimit të ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Sana të Jemenit. Kasem Aklani është qëlluar me armë zjarri nga një sulmues me motogjilet. Aklani ka punuar në ambasadën amerikane rreth 20 vjet. Qeveria e Jemenit, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, ka nisur kohë më parë ofensivën kundër degës së Al Kaidës në vend, duke kthyer kontrollin e disa qyteve në jug.

Opinionit juaj në ekranin tonë Çdo ditë në

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit



DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 51

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

ABCOM

KANALI 158

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Habjon Hasani

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847